# GAZETA SHQIPTARE

Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXIV - Nr. 7531 E enjte 17 Maj 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)









Intervista në 'Euronews'

Nga EDI RAMA

## Negociatat janë çështje 'jetë a vdekje', të hapen në qershor



Kryeministri Edi Rama e ka cilësuar një çështjeje 'jetë a vdekje' hapjen e negociatave të Shqipërisë me Bashkimin Evropian. Në një intervistë ...

Vijon në faqen 21

Opinioni i Ditës



Nga SULEJMAN MATO

## Gazetaria analitike dhe ca mendime të Montanelit

Na duhen analistë të vërtetë dhe jo tifozë partish? -A ka shkollë për t'u bërë shkrimtar? E pyeti një ditë një nxënëse shkrimtarin Kolë Jakova, në një ...

Vijon në faqen 22



Dorëzohet Agron Xhafaj: Nuk i jam shmangur drejtësisë

# Xhafaj: Audio-përgjimi mashtrim, prokuroria të nisë hetimet për këtë veprim mafioz

Rama: Ministri në detyrë, burg për ata që mashtruan. Basha: Përgjimet autentike, s'tërhiqemi, as nuk trembemi nga kërcënimet e kryeministrit

Nga DARINA TANUSHI & VALENTINA MADANI

Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj deklaroi dje se do të vazhdojë misionin e tij, në përputhje me ligjin dhe Kushtetutën, pavarësisht shpifjeve dhe qëndrimit të opozitës. "Në asnjë rast nuk kam menduar të jap dorëheqjen ...

Në faqet 2-5

AMBASADA E SHBA-VE: DY FAKTORET QE PERCAKTOJNE DATEN E INTERVISTES

# FITUESIT E LOTARISE, HAPAT QE DUHEN NDJEKUR

Verifikoni saktë të dhënat që keni përdorur gjatë aplikimit fillestar dhe çfarë duhet të bëni që të mos ju refuzohet viza për tokën e premtuar



(Në foto) Ambasada amerikane në Tiranë

Në faqen 11

DETAJET E MBLEDHJES

## Presidenti Meta thërret Këshillin e Sigurisë Kombëtare: Thelloni luftën ndaj krimit

Në faqen 3

LISTA EMERORE

## ALUIZNI: Legalizimet, 650 personat që përfitojnë tapitë në Kamëz dhe Vorë

Në faqet 6-7

VENDIMI DHE HISTORIA

## Masakra e Dajçit me 2 viktima e 4 të plagosur, burg përjetë Parubit: Isha i droguar, i mora në qafë

Në faqen 13

KULTURE E TRASHEGIMI

## Festivali i librit, çfarë ndodhi me stendën "Çamëria" dhe reagimet e PDIU

Në faqen 14

"USHQIMET QE NUK DUHET T'I PERDORNI"



## Ylli Merja: Përdorimi i vajit të mendrës për kurimin e inflamacionit në zorrën e trashë

Në faqen 10

Përfituesit duhet të dorëzojnë dokumentet për të marrë 20% të vlerës së pronës në para

# ATP: Lista me 1800 pronarë dhe vlerësimi financiar

*Dosjet e vitit '98, gjashtë muaj kohë për të plotësuar dokumentet*

Nga ORNELA MANJANI

Agjencia e Trajtimit të Pronave ka vlerësimet financiare për ish-pronarët që kanë dorëzuar kërkesën për kompensim në vitin 1998. Agjencia bën të ditur se në përfundim të procesit të verifikimit të vendimeve



të administruara pranë arkivës së ATP-së, u identifikuan rreth 1800 vendime të vitit 1998, të cilat kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuara. Të dhënat lidhur me numrin e vendimit, gjeneralitetet ...

Në faqet 15-17

# AKUZAT NDAJ XHAFAJT

## REAGIMET

### Ministri sqaron akuzat për të vëllain: I paraqita dorëheqjen Majkos në 2002-shin

# Xhafaj: Nuk kam menduar të dorëhiqem, askush s'më shantazhon, audio mashtrim

## *Momentet e vështira që kaloi familja prekin ministrin*

Darina Tanushi

Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj deklaroi dje se do të vazhdojë misionin e tij, në përputhje me ligjin dhe Kushtetutën, pavarësisht shpifjeve dhe qëndrimit të opozitës. "Në asnjë rast nuk kam menduar të jap dorëheqjen për këtë shkak. Do të jepja dorëheqjen për çdo shkak tjetër që të kishte lidhje me mua dhe me përgjegjësitë e mia në zbatim të ligjit dhe përballë qytetarëve", tha ministri. Në një konferencë për shtyp, dje pasdite, Fatmir Xhafaj sqaroi sërish historinë e vëllait të tij në vitin 2002, ndërsa tha se ai ka shkuar të vuajë dënimin në Itali me vullnetin e tij. "Siç është e njohur, vëllai im ka marrë një dënim penal në Itali. Ngjarja ka ndodhur në vitet 2002. Vëllai im ka qenë rreth 25 vjeç në atë kohë. Autoritet italiane e kanë ndaluar për rreth 1 muaj dhe e kanë liruar duke urdhëruar largimin e tij nga Italia. Në atë kohë, unë kam qenë ministër i Turizmit në qeverinë me kryeministër z. Pandeli Majko. I pa detyruar nga ndonjë normë kushtetuese, apo ligjore, në respekt të moralit, i kam kërkuar kryeministrit të kohës dorëheqjen", - sqaroi ministri historinë me vëllain e tij. Më tej ministri Xhafaj sqaroi se, "nëse im vëlla do të bënte njohjen e vendimit të tij këtu dhe do të priste ekzekutimin e tij për dënimin në ngarkim të tij, sipas ligjit shqiptar, ai nuk do ta vuante fare atë, pasi periudha prej 4 vjetësh e mbetur për ekzekutim është në afatin 5-vjeçar të parashikuar nga ligji shqiptar. Një precedent ky i zbatuar normalisht në praktikën gjyqësore në Shqipëri". Në lidhje me akuzat e PD-së se ka falsifikuar nenin 491 të Kodit Penal për të favorizuar të vëllain, Xhafaj i cilësoi qesharake. "Ky rregullim i ri në Kodin e Procedurës, por në fuqi më parë në ligjin e sipërcituar, nuk ka lidhje me rastin e vëllait tim, Agron Xhafaj dhe është sërish një mashtrim i rëndë publik. Dispozita e thotë qartë, mbrohen vetëm ata që janë dënuar në mungesë, pra në kushtet kur nuk është siguruar e drejta për një proces të rregullt ligjor sipas nenit 6, të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut", sqaroi Xhafaj, i cili tha se vëllai i tij ka pasur dijeni dhe është përfaqësuar. "Lidhur me akuzat për përfshirje të vëllait tim në trafikun e drogës në Shqipëri, është komplet një mashtrim dhe shpifje e ulët ajo që thuhet në lidhje me përfshirje të vëllait tim në këtë veprimtari. Marr të gjitha përgjegjësitë ligjore dhe morale nëse ka qoftë edhe një grimcë të vërtetë në lidhje me këto akuza. Prej vitit 2002 vëllai im, Agron Xhafaj ka jetuar në Shqipëri dhe është një ndër qytetarët e shumtë të këtij vendi, që nuk ka asnjë problem me ligjin", theksoi më tej ministri. Ministri sqaroi se, "audio-përgjimi i servirur me pompozitet publikut është një sajesë e plotë nga fillimi deri fund. Është një manipulim dhe i bërë keq madje. Nëse opozita nuk e ka bërë vetë këtë dhe sinqerisht nuk dua ta besoj se është ajo nxitësja dhe realizuesja e këtij akti skandaloz, ajo ka rënë viktimë e të tjerëve. Gjithsesi, kushdo i përfshirë në këtë skandal të madh do të marrë përgjigjen e merituar. Veprimi është tipik mafioz, ndaj do t'i kërkoj sot publikisht prokurorisë veprime të shpejta dhe energjike për gjetjen të gjithë atyre që janë përfshirë në këtë aferë kriminale dhe dënimin në mënyrën më të merituar", u shpreh Xhafaj. E duke iu drejtuar opozitës, Xhafaj tha: "Nëse mendoni të më mposhtni me sulmet tuaja, gaboni. Thjesht nuk kam frikë! Askush nuk mund të më shantazhojë! Askush nuk do të mund të më pengojë në arritjen e qëllimeve të larta, të asaj çfarë kam marrë përsipër të bëj së bashku me bashkëpunëtorët e mi dhe me mbështetjen e partnerëve: luftë pa kompromis me krimin, gjithmonë në zbatim të ligjit, në shërbim të qytetarëve dhe vetëm të qytetarëve".



Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj

**FAMILJA**

"Ne do të gjejmë forcë dhe kurajë për ta përballuar këtë situatë të pazakontë familjare, për t'ua bërë sa më të lehtë e sa më të përballueshme nënës, bashkëshortes dhe sidomos dy fëmijëve të tij në moshë të vogël, përkatësisht 15 dhe 11 vjeç", tha dje Xhafaj, e në të njëjtën kohë u vu re dridhja e zërit, kur u përmend familja.



Dje në mbledhjen e Këshillit të Sigurisë Kombëtare

## Vëllai i ministrit: Audio-përgjimi i opozitës, i sajuar

### Agron Xhafaj, letër publike: Dorëzohem tek autoritetet italiane, nuk jam shmangur

Agron Xhafaj, vëllai i ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj ka marrë dje vendimin për të shkuar vetë tek autoritetet italiane për të vuajtur dënimin. I vendosur në qendër të akuzave së bashku me vëllain e tij ministër, Agron Xhafaj sqaroi dje në një letër: "Kam vendosur që t'u drejtohem vetë autoriteteve italiane të drejtësisë për të ekzekutuar një vendim dënimi penal të tyre kundrejt meje. Kam vendosur ta bëj këtë duke u paraqitur sot në Itali tek autoritetet përkatëse. Edhe pse nuk ka pasur asnjëherë (nuk ka akoma edhe sot) asnjë kërkesë dhe asnjë interes nga organet e drejtësisë italiane për të ekzekutuar këtë vendim, edhe pse unë asnjëherë nuk kam qenë në kërkim për ekzekutimin e këtij vendimi, unë po e kryejë këtë akt. Unë kam gabuar në rininë time. Si jo pak të tjerë. Aspak dhe për asnjë arsye nuk e justifikoj dhe nuk e përligj atë gabim. Edhe pse cilido që ka pasur mundësinë të shohë atë dosje penale dhe ka parë rrethanat e kryerjes së asaj vepre penale, e kupton shumë mirë shkallën e përfshirjes dhe rolin tim në atë histori", u shpreh Agron Xhafaj. Por, shton ai më tej: "Unë jo vetëm që nuk i jam shmangur hetimit dhe gjykimit tim në këtë çështje, por përkundrazi, kam bërë të gjitha përpjekjet e mundshme për të qenë prezent në Itali gjatë hetimit dhe më pas gjatë gjykimit tim. Janë të plota dhe të dokumentuara të gjitha përpjekjet e mia në këtë drejtim. Ishin vetë autoritetet italiane që më liruan pas një muaji ndalimi dhe urdhëruan largimin tim nga Italia". Ai ka sqaruar se ka lënë pranë prokurorisë të gjitha shpjegimet dhe zërin e tij për të verifikuar audion e publikuar nga opozita, të cilën e quan të sajuar.



## OPOZITA

### Alibeaj: Xhafaj paralajmëroi Ramën se largimi i tij do rrëzojë qeverinë

Deputeti i PD-së, Enkelejd Alibeaj e krahasoi Fatmir Xhafajn me Saimir Tahirin. Në një reagim të tij pas daljes së ministrit Xhafaj, deputeti demokrat u shpreh: "Fatmir Xhafaj ndoshta nuk ka një dosje aq të pasur sa të Saimir Tahirit për Edi Ramën, por ai njësoj si Tahiri, paralajmëroi Ramën se largimi i tij do të thotë rënie e qeverisë. Për të bërë këtë kërcënim për Ramën, ministri i Brendshëm akuzoi opozitën se po bashkëpunon me djallin për të rrëzuar qeverinë. Por, kjo është më e parëndësishmja dhe pjesë e luftës së tyre të brendshme për pushtetin e kriminalizuar deri në palcë. E vërteta është se materiali audio provoi se Agron Xhafaj nuk bën një jetë normale, por është drejtues i trafikut të drogës, nën mbrojtjen e të vëllait ministër të Brendshëm. Fatmir Xhafaj, njësoj si Edi Rama, e di se përgjimi është i vërtetë dhe se Agron Xhafaj ka vazhduar trafikun e drogës, veçanërisht gjatë kohës që i vëllai është ministër i Brendshëm. Kjo është arsyeja e vetme pse Agron Xhafaj u dërgua në Itali pa ia nxjerrë më parë opinionit publik me zë dhe me figurë", u shpreh Alibeaj. "Është gënjeshtër dhe mashtrim përgjigja e tij se nuk është subjekt i ligjit antimafia. Është gënjeshtër dhe mashtrim se ai nuk i pengon hetimet për vëllain trafikant droge nga detyra e ministrit të Brendshëm. Është kriminale akuza e Fatmir Xhafajt se opozita vepron për llogari të interesave kriminale", u shpreh deputeti i PD-së. "Ne as nuk jemi trembur dhe as nuk tërhiqemi nga sulmet e një bande kriminale qeverisëse që kërcënon me burg opozitën, por jo kriminelët dhe trafikantët e drogës. Beteja jonë do të vazhdojë me të njëjtën forcë", u shpreh Alibeaj.




REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA: **Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416, ***Marketingu*:** Cel:0682074415-***email:marketing@gazetashqiptare.com***, **ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu*:** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**



### Kreu i shtetit: Agjencitë ligjzbatuese të thellojnë luftën ndaj krimit e drogës

# Rama e Xhafaj shkojnë te Meta, presidenti thërret Këshillin e Sigurisë Kombëtare



Presidenti i Republikës, Ilir Meta dhe kryeministri Edi Rama, dje në mbledhjen e Këshillit të Sigurisë Kombëtare

"Për gjendjen e sigurisë kombëtare dhe direktivën vjetore të sigurisë së Republikës së Shqipërisë për vitin 2018 informoi kryeministri Edi Rama. Për çështjet e tjera informuan anëtarët e tjerë të Këshillit të Sigurisë Kombëtare.

Presidenti i Republikës, Ilir Meta mblodhi dje Këshillin e Sigurisë Kombëtare. Sipas njoftimit për mediat, "çështjet e diskutuara ishin gjendja e sigurisë kombëtare dhe direktiva vjetore e sigurisë së Republikës së Shqipërisë për vitin 2018; kontrolli dhe menaxhimi i integruar i kufijve, lufta kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe emigracionit të paligjshëm; emergjencat civile; siguria e infrastrukturave strategjike portuale dhe aeroportuale dhe mbrojtja kibernetike". Por në fakt, kjo mbledhje vjen në një kohë që opozita ka hedhur akuza ndaj ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj, i cili ishte i pranishëm në mbledhje. "Për gjendjen e sigurisë kombëtare dhe direktivën vjetore të sigurisë së Republikës së Shqipërisë për vitin 2018 informoi kryeministri Edi Rama. Për çështjet e tjera informuan anëtarët e tjerë të Këshillit të Sigurisë Kombëtare. Presidenti theksoi rëndësinë e domosdoshmërisë strategjike për luftën kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe forcimit të kontrollit të kufijve", thuhet në njoftimin e Presidencës. "Gjithashtu, presidenti shprehu mbështetjen e plotë ndaj agjencive ligjzbatuese për thellimin e luftës pa kompromis kundër trafikut të drogës dhe krimit të organizuar. Po kështu, raportet e Departamentit të Shtetit, Bashkimit Evropian dhe agjencive partnere të specializuara për këto çështje të rëndësishme - nënvizoi Presidenti i Republikës - janë një platformë solide për të reflektuar dhe për të ndërtuar një partneritet të besueshëm, të qëndrueshëm dhe afatgjatë për forcimin e sigurisë kombëtare dhe anëtarësimin në Bashkimin Evropian", përfundon njoftimi.

### Audio-përgjimi për vëllain e ministrit, kryeministri: Nuk kemi njerëz për të lëshuar në dhëmbët e ujqërve

# Rama: Xhafaj në detyrë, burg për ata që mashtruan

## *"Audion e çuam në një prej laboratorëve më seriozë në botë, akuzat e PD marrëzi"*

Darina Tanushi



Kryeministri Edi Rama, dje në mbledhjen e grupit parlamentar të PS-së

Kryeministri Edi Rama u shpreh qartë dje para deputetëve socialistë në mbledhjen e grupit parlamentar se Fatmir Xhafaj do të qëndrojë në detyrë dhe nuk ka pse të përgjigjet as ligjërisht dhe as moralisht. I sapokthyer nga Parisi, ku takoi presidentin Makron, Rama tha se kishte dëgjuar prej tij "fjalë tejet inkurajuese për Shqipërinë". Pasi theksoi se është optimist për vendimin e Francës për hapjen e negociatave të Shqipërisë me BE-në, Rama foli gjatë për sulmet e ditëve të fundit të opozitës ndaj ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj. Ndërsa renditi sukseset e arritura, sipas tij, nga qeveria socialiste në luftën ndaj krimit të organizuar dhe drogës, Rama u shpreh: "Sot na del edhe që drejtuesi i reformës në drejtësi, ministri ynë i Brendshëm, na qenka kryetari i familjes së dytë mafioze në Ballkan, madje në Europë, pëllet Saliu, natyrisht pas meje dhe familjes sime! Ministri i Brendshëm paska fshehur prej 6 vitesh dënimin me burg të të vëllait në Itali, për një vepër të kryer më shumë se 15 vjet më parë! Dhe ky 'sekret mafioz' u zbulua nga opozita jonë dhe u shpërnda jo vetëm në median tonë, e cila pati një shok amnezik dhe nuk u kujtua dot se sa shumë herë të tjera e kishte publikuar këtë fakt në vite, por edhe në të gjitha faqet e 'Facebook'-ut të kryeministrave të vendeve anëtare të Bashkimit Europian. Ministri i Brendshëm, dora vetë, paska qenë edhe një diversant i krimit të organizuar në krye të reformës në drejtësi, ku qenka infiltruar për të desantuar të fshehtësi një nen klandestin, me qëllim mosekstradimin në Itali të vëllait të tij! Po, lavdi Zotit të madh, që shqiptarët kanë opozitën syfajkua dhe hundëçakall, e cila e zbuloi edhe këtë 'akt mafioz legjislativ' kaq tronditës për mediat tona, të cilat nuk e mblodhën dot veten për të bërë një verifikim të thjeshtë fare, duke u bërë një pyetje te vetme partnerëve të EURALIUS-it dhe të OPDAT-it", ironizoi Rama. "Maskarada e kësaj here meriton në përgjigje të qartë në rrafshin politik, por edhe një përgjigje shembullore në rrafshin e hetimit dhe të ndëshkimit penal. Paralelisht me kërkesën e menjëhershme publike të kryetarit të grupit parlamentar për një hetim imediat nga prokuroria të materialit audio të shfaqur nga opozita, e cila e ka marrë përgjegjësinë e autenticitetit të incizimit, unë kam kërkuar nga një agjenci e specializuar ndërkombëtare ekspertizën shkencore të këtij materiali dhe po ashtu kam vënë në lëvizje burimet e duhura zyrtare për mbledhjen e çdo informacioni të disponueshëm të agjencive përkatëse dhe partnere mbi çdo indicie të mundshme lidhur me vëllain e ministrit të Brendshëm", u shpreh Rama.

### TAKIMI

Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj u takua për gati një orë me kryeministrin Rama në zyrën e këtij të fundit, menjëherë pas mbledhjes së grupit parlamentar të PS-së. I pranishëm për disa minuta ishte edhe kryetari i grupit të PS, Taulant Balla, i cili më pas është larguar nga Kryeministria.

### REAGIMET PËR TAHIRIN

Kryeministri tha se ka ndjekur reagimet në rrjetet sociale, që në thelb, sipas tij, përmblidhen me fjalitë: "Mos e lësho dhe Fatmirin, siç e lëshove Saimirin; Saliu nuk ka lëshuar vrasës e kriminelë me damkë, ndërsa ti je gati të lëshosh kë të dojë Saliu. E lëshove një ministër të Brendshëm me incizime, mos lësho dhe këtë tjetrin, për të mbajtur karrigen tënde. E të tjera me radhë". Duke u shprehur para deputetëve me fjalët: "Ne nuk jemi si ata" dhe duke pasur parasysh opozitën, Rama sqaroi: "Unë jam i gatshëm të bëhem copë dhe e kam bërë, për të mbrojtur punën e një ministri, një kryetari bashkie, një deputeti apo kujtdo bashkëpunëtori, që ia di dhe ia vlerësoj punën që bën, edhe kur të gjithë mund ta kenë rrethuar me kundërshtitë e tyre. Por kurrë nuk kam qenë e as mos e prisni ndonjëherë të jem i gatshëm të mbroj askënd dhe as të angazhoj Partinë Socialiste për të bërë avokatin e kujtdo qoftë, kur është fjala për t'u përballur me akuzat e organeve të drejtësisë, cilado qoftë drejtësia! 100 herë po të ktheheshim në atë shfaqjen famëkeqe të Prokurorisë së Krimeve të Rënda, ku u kërkua arrestimi i Saimir Tahirit në parlament, 100 herë, ne do të mbanim të njëjtin qëndrim e unë do të mbaja të njëjtin fjalim. Jo për të mos lëshuar njeriun tonë, por në mbrojtje të pikërisht të drejtës sonë kushtetuese për të refuzuar një padrejtësi, të cilën Kushtetuta na e njeh mundësinë ta gjykojmë, kur prokuroria vjen këtu në parlament - u shpreh Rama. - Dua ta nënvizoj qartë se ne nuk kemi njerëz për të lëshuar në dhëmbët e ujqërve, por nuk jemi njerëz që u kërcasim dhëmbët organeve të drejtësisë, kur cilido prej nesh vihet nën akuzë prej tyre. Akuza apo akuzat sot ndaj ministrit të Brendshëm nuk vinë nga organet e drejtësisë e nuk kanë asnjë lidhje me të drejtën si vlerë, por ato as nuk mund të neglizhohen si shumë e për lumë akuza që na bëhen e do të na bëhen përditë e as nuk mund të lihen vetëm me sqarimet e radhës, sepse tanimë, në majën e thikës së tyre qëndron një material konkret, për të cilin dikush duhet të përgjigjet jo me fjalë, por me burg dhe do ta shpjegoj pse, por më parë do të shpjegoj pse sipas meje, sot që flasim, ministri i Brendshëm nuk duhet të përgjigjet. Ligjërisht jo e jo, por as moralisht", theksoi Rama. Ai u shpreh se e ka ditur historinë e vëllait të Xhafajt, ndërsa cilësoi "marrëzi" akuzat se është ndryshuar neni i Kodit Penal për të favorizuar Agron Xhafaj. "Unë e kam marrë mbrëmë përgjigjen e analizës shkencore, të kryer në një ndër laboratorët më seriozë të botës. Mua, ajo përgjigje më mjafton", tha Rama duke sqaruar se ai nuk është autentik dhe duke kërkuar hetim nga prokuroria. Rama tha se kaq i mjafton për të thënë se "ministri i Brendshëm duhet të vazhdojë të kryejë detyrën, por nuk e bëjnë asnjë çikë më pak urgjente, nevojën urgjente për një hetim shteruese të prokurorisë. Sepse mua në këtë rast më takon gjykimi politik, por jo ai ligjor e ai penal. Në asnjë rast".

PROTESTA

OPOZITA

Dorëheqja, opozita në protestë me vezë dhe "drogë" poshtë zyrës së Xhafajt, sot në Kuvend

# Paralajmërimi i Palokës: Rama do pendohet, do ia dëgjojë krismën

## "Historia sapo ka filluar, s'ka parë gjë akoma"

Valentina Madani

Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj ndodhej në mbledhjen e grupit parlamentar kur deputetë dhe mbështetës të opozitës protestuan poshtë zyrës së tij. Protestës së opozitarë nuk i kanë munguar as simbolet. Protestuesit vendosën në derën e ministrisë disa kuti që simbolizojnë drogën, të cilat janë porosi për vëllain e ministrit, Agron Xhafajn. Nëpër kutitë shkruhej: "Porosi për Geronin", "Taksirat o Gone, ma hidh përtej detit", "Pako për Agronin", "Çoma dhe mua këtë plaçkën tutje pasha", "Kjo është porosia e Olsit, më tha ta sjell ty". Ndërsa në pankartat që mbanin në duar protestuesit shkruhej: "Do punë? Lidhu me Ermalin", "Rama-Tahiri-Xhafaj, Shqipëria jashtë Europës", "Xhafaj-Tahiri, dyshja e krimit", "Xhafaj, koka e krimit". Kordonin e forcave të policisë që ishin vendosur në perimetrin e godinës së Ministrisë së Brendshme tentuan ta thyejnë që nisje të protestës. Krahas kutive të kartonit që simbolizonin pakot me drogë, të rinjtë e FRPD-së, të cilët ishin në krye të protestës, qëlluan edhe me vezë në drejtim të Ministrisë së Brendshme. "Rama mbajti qëndrimin që pritej, asgjë më shumë. Shfaqjen e radhës që po shohim, e pamë me Tahirin që e mbrojti me të njëjtat fjalë, sot ai është në arrest shtëpie se drejtësia është e kapur. Të njëjtin 'show' pamë edhe sot për Xhafajn, me argumente absurde mbrojti ministrin e tij se po mbron veten. Ai i dha urdhër prokurorisë, por do t'ia dëgjojë krismën, kupola ka në krye Ramën, mafia kështu funksionon. Tha se do përgjigjet opozita. Kapet Tahiri në krim, do përgjigjet opozita; kapet Xhafaj do përgjigjet opozita. Ajo shprehja s'ka parë gjë akoma, ky është edhe rasti Xhafaj. Protesta e sotme (djeshme) është vetëm një hap i qytetarëve që na kërkuan t'i mbështesim, nuk do të ndalemi deri sa Xhafaj të ikë dhe Rama të shkojë atje ku duhet, Rama do të pendohet", - tha Paloka. Sipas tij, Rama është koka e krimit dhe përgjegjësinë do e mbajë ai. "Fajtore ishte opozita dhe media, jo ata që i bëjnë krimet. U kthye prapë tek historia me agjentë rusë. Kapet Xhafaj në krim, do përgjigjet opozita dhe media. Ajo shprehja 'ky s'ka parë asgjë akoma' është i vlefshëm për rastin 'Xhafaj'. Rama do pendohet shumë shpejt. Nuk do ndalemi deri sa Xhafaj të ikë dhe Rama të ikë. Kjo histori sapo ka filluar", theksoi Paloka. Më herët demokratët bllokuan sikundër dy ditë më parë vijimin normal të punimeve të komisioneve parlamentare, ku sërish kër-kuan dorëheqjen e ministrit Xhafaj. Opozita ka paralajmëruar se do të bllokojë edhe seancën e sotme plenare, nëse ministri Xhafaj nuk do të dorëhiqej.


Protesta e djeshme e opozitës

**PANKARTAT**

Nëpër kutitë shkruhej "Porosi për Geronin", "Taksirat o Gone, ma hidh përtej detit", "Pako për Agronin", "Çoma dhe mua këtë plaçkën tutje pasha", "Kjo është porosia e Olsit, më tha ta sjell ty". Ndërsa në pankartat që mbanin në duar protestuesit shkruhej: "Do punë? Lidhu me Ermalin", "Rama-Tahiri-Xhafaj, Shqipëria jashtë Europës", "Xhafaj-Tahiri, dyshja e krimit", "Xhafaj koka e krimit".



**AKUZA**

"Qep ligjin sipas masës së vëllait. As ekstradohet, dhe as i ekzekutohet vendimi në Shqipëri, duke e kthyer këtë vend si një mbrojtës dhe amnistues të gjithë radhës së kriminelëve që sot janë thirrur nën armë nga kjo qeveri, duke e kthyer këtë vend në parajsë kriminale", tha Alibeaj.

### Alibeaj: Ministri qep ligjin sipas masës së të vëllait

## Opozita bllokon komisionet, PS: Turp t'ju vijë! PD: Zëvendësja e Xhafajt të dalë jashtë



Opozita bllokoi sërish dje komisionet parlamentare duke kërkuar dorëheqjen e ministrit Fatmir Xhafaj. Deputetët e PD-së ishin dje në komisionin për të Drejtat e Njeriut, ku po diskutohej për të zhdukurit. Deputeti i PD, Alibeaj u shpreh se nuk ka vend më të mirë për të diskutuar çështje kaq shumë të rëndësishme. "Xhafaj qep ligjin sipas masës së të vëllait. As ekstradohet dhe as i ekzekutohet vendimi në Shqipëri, duke e kthyer këtë vend si një mbrojtës dhe amnistues të të gjithë radhës së kriminelëve, që sot janë thirrur nën armë nga kjo qeveri, duke e kthyer këtë vend në parajsë kriminale", deklaroi deputeti i PD-së, Alibeaj. Por, Vasilika Hysi reagoi duke thënë se, "kemi mbi 5 mijë persona të zhdukur dhe kjo duhet të ishte kauza juaj". Por, demokrati Oerd Bylykbashi tha: "Fatmir Xhafaj e ktheu parlamentin në strehë të të gjithë kriminelëve të dënuar për trafik droge". Më pas, Hysi ia dha fjalën zv.ministres së Brendshme, Rovena Voda, e cila u drejtua deputetëve të opozitës duke u thënë: "T'ju vijë turp që nuk flisni për rendin e ditës. Kaq mjaftoi që situata të precipitonte, pasi të gjithë deputetët e grupit të PD reaguan në bllok, duke i kërkuar që të dalë jashtë. Voda nuk pranoi, ndërsa opozita nuk hoqi dorë nga kërkesa". "Të largohet zv.ministrja tani, t'i ruhet nderi këtij komisioni", tha z.Bylykbashi. Deputeti Flamur Noka iu drejtua Vodës: "Largoje! Jashtë, jashtë, je një çerre e krimit". Në këtë situatë, Hysi vendosi që të ndërpriste punimet.

SHKURTE

### Hapja e negociatave, Ruçi merr mbështetjen e Greqisë, Bullgarisë dhe Rumanisë

Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi, mori pjesë në Konferencën e Krerëve të Parlamenteve të Vendeve të Detit të Zi, në Stamboll. Gjatë mbledhjes së Asamblesë Parlamentare, kryetari i Kuvendit takoi homologët e Parlamenteve të Greqisë, Bullgarisë, Rumanisë dhe u kërkoi mbështetjen për çeljen e negociatave të BE-së me Shqipërinë në mbledhjen e qershorit 2018. Kreu i parlamentit grek, Nikos Voutsis, premtoi se Shqipëria ka mbështetjen e plotë të Greqisë për hapjen e negociatave në mbledhjen e qershorit dhe kjo mbështetje është e merituar. Kryetarja e Parlamentit të Bullgarisë, Tsveta Karayahncheva, nënvizoi se Bullgaria si vendi që ka presidencën e BE, mbështet plotësisht integrimin evropian të Shqipërisë dhe hapjen e negociatave në mbledhjen e qershorit. Për më tepër, Presidenca Bullgare do të bëjë një paraqitje mjaft pozitive të arritjeve të Shqipërisë në plotësimin e kritereve të integrimit. Kryetari i Senatit të Rumanisë, C?lin Popescu-T?riceanu, premtoi se Rumania do të jetë një avokate e fuqishme e Shqipërisë për çeljen e negociatave në mbledhjen e qershorit, si një hap drejt integrimit të Shqipërisë dhe stabilitetit e prosperitetit në Ballkanin Perëndimor.

### Berisha: Agron Xhafajn policia italiane e mori me fugon të veçantë

Ish-kryeministri Sali Berisha, që denoncoi i pari atë që e quajti operacion sekret të udhëtimit të Agron Xhafajt në Itali, deklaron se ai ka mbërritur në Romë. Referuar një denoncuesi dixhital, Berisha shkruan se Xhafaj ka mbërritur në Romë pak para orës 11:00 të paradites së djeshme. Ai shton se vëllai i ministrit të Brendshëm shoqërohej nga dy oficerë të policisë shqiptare dhe u mor nga një mikrobus i policisë italiane. "Baroni i drogës, Agron Xhafaj pritet në aeroportin e Romës nga policia italiane. Sapo mbërritën në aeroportin e Romës me avionin e nisur në ora 04:00 të mëngjesit, Agron Xhafaj, i shoqëruar nga dy oficerë të policisë shqiptarë, me të zbritur në aeroport e morën me një mikrobus të veçantë policë italianë!", theksoi z.Berisha.



Kreu i PD-së: Përgjimet autentike, kryeministri mbrojti Xhafajn, sepse krimi është në pushtet

# Basha: Nuk tërhiqemi, as nuk trembemi nga kërcënimet e Ramës

## "Qëndrimi në detyrë deformon dhe pengon hetimin"

Valentina Madani



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

**PARALAJMËRIMI**

"Kërcënimi me burg i opozitës që denoncoi skandalin 'Xhafaj' është skandaloz, tipik për udhëheqësit autokratë dhe të inkriminuar. Ne as nuk jemi trembur dhe as nuk tërhiqemi nga sulmet e një kryeministri që kërcënon me burg opozitën, por jo kriminelët dhe trafikantët e drogës!", deklaroi z.Basha.

Partia Demokratike është e bindur në fajësinë e Fatmir Xhafajt dhe marrjen në mbrojtje të ministrit nga ana e Edi Ramës këtë të mërkurë dhe e sheh identik me rastin e Saimir Tahirit, Elvis Roshit, Mark Frrokut dhe Arben Ndokës. Kreu i PD, Lulzim Basha iu përgjigj kryeministrit Rama, pas mbrojtjes që i bëri ministrit Fatmir Xhafaj, duke konfirmuar se nuk do të ketë lëvizje sa u përket zërave për largimin e ministrit. Në një status në 'FB', Basha akuzon Ramën se ashtu siç bëri me Tahirin, Frrokun apo Rroshin po bën edhe me Fatmir Xhafajn. Basha shprehet se kërcënimi me burg i opozitës që denoncoi skandalin "Xhafaj" është skandaloz, tipik për udhëheqësit autokratë dhe të inkriminuar, por premton që opozita nuk do të tërhiqet. "Ne as nuk jemi trembur dhe as nuk tërhiqemi nga sulmet e një kryeministri që kërcënon me burg opozitën, por jo kriminelët dhe trafikantët e drogës! Në emër të Partisë Demokratike, i siguroj shqiptarët dhe partnerët ndërkombëtarë se ne do ta vazhdojmë edhe më fuqishëm betejën me krimin e organizuar dhe do të përballemi me të njëjtën forcë me qeverinë që punon për krimin e organizuar dhe jo për qytetarët e ndershëm të këtij vendi", theksoi z.Basha. Ekspertët pritet të përcaktojnë nëse përgjimi i publikuar nga demokratët është montazh apo i vërtetë. Vetë Basha është i sigurt. "Sot ishte radha e Fatmir Xhafajt dhe vëllait të tij trafikant droge, i kapur në përgjime autentike ambientale, të pamanipuluara. Materiali audio provoi se Agron Xhafaj nuk bën një jetë normale, por është drejtues i trafikut të drogës, nën mbrojtjen e të vëllait minsitër i Brendshëm", deklaroi kreu i PD-së. Basha shprehet se kryeministri Rama është në dijeni të aktivitetit të Agron Xhafajt, madje edhe që përgjimi është autentik. "Këtë fakt nuk e mohoi dot as vetë Edi Rama sot, sepse ai e di që Agron Xhafaj është një nga kokat e krimit. Edi Rama ka mjaftueshëm informacion për fuqinë e Agron Xhafajt mbi policinë e Vlorës, Policinë e Shtetit dhe rrjetit të tij kriminal në Vlorë. Edi Rama e di se përgjimi është i vërtetë dhe se Agron Xhafaj ka vazhduar trafikun e drogës, veçanërisht gjatë kohës që i vëllai është minister i Brendshëm", theksoi kreu i PD-së. Dorëzimin e Agron Xhafajt tek autoritetet italiane, Lulzim Basha e interpreton si përpjekje për të mos e vënë atë përballë opinionit publik. "Kjo është arsyeja e vetme pse Agron Xhafaj po dërgohet në Itali pa ia nxjerrë më parë opinionit publik me zë dhe me figurë. Shqiptarët duan të dëgjojnë vetë zërin e Agron Xhafajt dhe jo të dëgjojnë prej Edi Ramës rezultate ekspertize nga laboratorë pa emër apo nën pushtetin e tij", shton ai. Shfaqjen e Edi Ramës, kryedemokrati Basha e quan të "neveritshme dhe të pabesueshme, sa ishte dy vjet më parë, kur u mohonte shqiptarëve se Agron Xhafaj ishte i dënuar për drogë". "Shqiptarët kanë shumë halle dhe probleme, por ata nuk harrojnë se Edi Rama u tregoi dy vjet më parë se historia me drogë e vëllait të Fatmir Xhafajt ishte e sajuar, ndërsa sot pranoi se për këtë histori droge, Agron Xhafaj po shkon në burg me këmbët e veta", tha kreu i PD-së. Për Bashën, Fatmir Xhafaj është subjekt i ligjit antimafia dhe kryeministri Edi Rama e anashkaloi këtë. "Në asnjë rresht të deklaratës së tij, Edi Rama nuk u dha llogari shqiptarëve pse Fatmir Xhafaj ka penguar zbatimin e ligjit antimafia për pasurinë e të vëllait, i dënuar për trafik droge dhe rrjedhimisht, edhe për pasurinë e vet, siç e kërkon me detyrim ligji antimafia", vijon ai. Mbrojtjen e ministrit të Brendshëm nga ana e kryeministrit Rama, kryetari i PD-së e lexon si një provë e re sesi krimi i organizuar drejton të gjithë segmentet e shtetit: qeverinë, policinë dhe prokurorinë. Për Bashën, duke qëndruar në detyrë, Fatmir Xhafaj deformon dhe pengon hetimin ndaj tij dhe të të vëllait, si për trafikun e drogës nga Agron Xhafaj, ashtu edhe për pasurinë sipas ligjit antimafia.



### PPE, Daul: Shkëputni lidhjet e politikës me krimin

Kreu i PD-së, Lulzim Basha, u takua në Sofje me Presidentin e PPE, Joseph Daul, i cili e përgëzoi Bashën për qëndrimin e opozitës në luftën kundër krimit të organizuar. Basha konfirmoi qëndrimin e opozitës për hapjen e negociatave të Shqipërisë me BE. "Moshapja e negociatave - theksoi Basha - do të ndëshkonte Shqipërinë dhe shqiptarët, që presin dhe meritojnë standarde europiane dhe do të ndihmonte krimin dhe politikanët që kanë tradhtuar interesat e Shqipërisë dhe qytetarëve shqiptarë, duke bashkëpunuar me krimin për pushtetin dhe pasurimin e tyre". Presidenti i PPE, Joseph Daul e garantoi kryetarin e Partisë Demokratike për mbështetjen dhe ndihmën e Partisë Popullore Europiane për shpalosjen e vizionit dhe planit të demokratëve për çlirimin e shtetit nga kapja e krimit të organizuar, për shkëputjen e lidhjeve të politikës me krimin, luftën kundër korrupsionit, për rritjen ekonomike dhe rikthimin e shpresës në vend.

### Vasili: BE në Tiranë gënjen, bën alibinë e skandalit

## Ndryshimi i nenit të ekstradimeve, delegacioni i BE: Nuk u ndryshua thelbi



**DEKLARATA**

Delegacioni i BE-së sqaroi se, "thelbi i varianteve të ndryshme mbeti i pandryshuar gjatë gjithë diskutimeve, përfshirë edhe variantin përfundimtar të miratuar të nenit 491 (f) të Kodit".

Delegacioni i Bashkimit Europian reagoi dje lidhur me debatin e hapur mbi ndryshimin e nenit për ekstradimet në Kodin e Procedurës Penale. Duke ju përgjigjur interesimit të "Zërit të Amerikës" për këtë çështje, duke qenë se i gjithë procesi i reformës në drejtësi dhe paketa e ligjeve shoqëruese u asistua ngushtësisht dhe nga misioni europian EURALIUS, delegacioni i BE-së sqaroi se, "ka pasur variante të ndryshme rreth Nenit 491 (f) të Kodit të Procedurës Penale, që janë diskutuar nga grupi i punës për Rishikimin e Kodit të Procedurës Penale, pjesë e të cilit ka qenë edhe EURALIUS, deri në miratimin e ndryshimeve të Kodit më 30 mars 2017. Thelbi i varianteve të ndryshme mbeti i pandryshuar gjatë gjithë diskutimeve, përfshirë dhe variantin përfundimtar të miratuar të Nenit 491 (f) të Kodit". Por, kreu i deputetëve të LSI-së, Petrit Vasili, u shpreh se delegacioni i BE në Tiranë gënjen lidhur me debatin e hapur mbi ndryshimin e nenit për ekstradimet në Kodin e Procedurës Penale. "Për të gjithë opinionin publik duhet të jetë e qartë se EURALIUS gënjen kur thotë ka pasur disa variante për nenin 491. Ka pasur vetëm një variant të përgatitur nga grupi i ekspertëve të nivelit të lartë dhe të paraqitur në Kuvendin e Shqipërisë me firmën e një deputeteje. Komisioni i Ligjeve në shkelje flagrante e ka ndryshuar nenin 491 të ardhur në Kuvend dhe ky ndryshim nuk gjendet asgjëkund në procesverbalin Komisionit të Ligjeve, që dokumenton ndryshimet që i bëhen projektligjit të propozuar dhe që më pas i paraqiten seancës plenare për votim. Ky është manipulim sa një mal. Vetëm BE në Tiranë dhe EURALIUS çuditërisht nuk e shohin dhe paskan marrë detyrën të bëjnë alibinë e këtij skandali", tha z.Vasili.Som

SHOQËRIA PËRMBARIMORE GJYQËSORE "3H" Sh.p.k
Adresa: Rr." Demokracia" Pll.1, Kt.1, Vore, Tirane. .
Web: www.3-h.al; Email: shpgj_3h@yahoo.com Tel/Fax +355(0) 44532482

Njofton shpalljen e ankadit nga **dt.17.05.2018 deri ne dt. 25.05.2018** per: sende të luajtshme mjeti me targe AA 957 GX Nissan Atleon 140, Vit prodhimi 2000, karburant-nafte, per skrap ne pronesi te Subjektit "Harizi Co" me Nipt K82122503F

**Çmimi fillestar eshte 78,400.00 (shtatedhjete e tetemije e katerqind) Leke Ankandi zhvillohet ne zyren permbarimore ne daten 25.05.2018 dhe mbyllet me orarin zyrtar 16.00.**

### Ministri i Financave: Tatimi ulet me tri herë për bizneset me xhiro 8-14 milionë lekë

# Ahmetaj: Ulet me 10 % tatimfitimi, përfitojnë 10 mijë biznese

## Ndryshime në ligjin për koncesionet/PPP, pas 2019 jo më oferta të pakërkuara"

Ornela Manjani

Nga 1 janari i vitit të ardhshëm, pragu që ndan bizneset e vogla nga i madhi do të rritet në 14 milionë lekë, nga 8 milionë lekë që është sot. Kjo do të sjellë automatikisht ulje të tatim fitimit nga 15 në 5% për 10,850 biznese, që janë gjysma e bizneseve që paguajnë tatim fitim në nivelin e 15%. Lajmi u bë i ditur nga ministri i Financave, Arben Ahmetaj, në një konferencë për mediat. Ahmetaj tha se do të rishikohet dhe ligji i koncesioneve, ku në thelb të tij do të jetë heqja e propozimeve të pakërkuara nga biznesi. "Ministria e Financave ka materializuar draftligjin për mendimmarrje në institucione të tjera dhe besojmë që ky ndryshim do të hyjë në fuqi jo më vonë se 1 janari i vitit 2019. Për statistikë, janë 21 mijë sipërmarrje që janë objekt i tatimfitimit 15%, me luhatje të qarkullimit nga zero deri në miliarda, dhe nga këto, 10,800 apo 50% të tyre iu zbritet tatimfitimit në 5%. Pra, duke iu shtuar dhe atyre që përfitojnë nga tatim-fitimi i thjeshtësuar, bëhen mbi 93 mijë biznese që kanë përfituar ulje të drejtpërdrejtë takse. Që do të thotë, se nga 110 mijë biznese aktive, mbi 93-95 mijë e kanë tatim fitimin nga 5 deri në zero. 90% e bizneseve të Republikës së Shqipërisë kanë përfituar ulje takse, janë 90 % e sipërmarrjeve shqiptare që në mandatin e parë dhe të dytë të qeverisë Rama, kanë përfituar ulje të ngarkesës fiskale. Janë 93-95 mijë biznese nga 110 mijë biznese"- tha Ahmetaj.

**RRITJA EKONOMIKE DHE PUNËSIMI**

Ekonomia shqiptare arriti rritjen më të madhe në 10 vjet, me 3.84% dhe pritet që të vazhdojnë me këto ritme, tha ministri i Financave, Arben Ahmetaj. Kjo ka ardhur nga investimet e brendshme, të huaja dhe përmirësimi i klimës së biznesit në vend. Papunësia në rajon është më e ulëta, ndërkohë që trendi është në rënie. Numri i të punësuarve ka arritur në 560 mijë, me rreth 240 mijë të punësuar më shumë në krahasim me vitin 2013, duke iu referuar listëpagesave të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Hapësirat për punësim janë ende të larta, tha Ahmetaj, sipas të dhënave nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit. Ahmetaj përmendi dhe të dhënat e Bankës së Shqipërisë për rritjen e besimit në ekonomi, i cili u rrit me 3.7 pikë në tremujorin e parë 2018. "Indeksi i shifrës së afarizimit shënoi rritje prej 4.7% në tremujorin e fundit të vitit 2017. Për investimet e huaja, Shqipëria ka nivelin e dytë më të lartë në rajon, pas Malit të Zi, në raport me prodhimin e brendshëm bruto. Eksportet kanë vijuar rritjen e qëndrueshme, me 18% për tre mujorin, ndërkohë që në kahun tjetër ka një rritje të lartë të importeve për makineri dhe pajisje edhe ky një tregues pozitiv për investimet e brendshme"-tha Ahmetaj.



Ministri i Financave, Arben Ahmetaj

**TË ARDHURAT**

"Të ardhurat tatimore, për janar-prill janë rritur me 4.5% në krahasim me faktin e katër muajve të parë të 2017-s. Kursi i këmbimit ka dëmtuar të ardhurat në dogana me 1.3 miliardë lekë, por shpresojmë ta kompensojmë me efektivitet në administrim",- tha ministri. Ahmetaj tha se janë rreth 5 mijë biznese të reja, që janë shtuar neto në katër muajt e parë të vitit. Ai shtoi se inflacioni në muajin prill ka qenë në nivele normale prej 2.1% dhe kjo tregon se nuk ka pasur ndikim në rritjen e çmimeve nga ulja e pragut të TVSH-së nga 5 në 2 milionë lekë.

**KURSI**

Lidhur me kursin e këmbimit Ahmetaj tha se ai është ndër më të qëndrueshëm në rajon. Ai reflekton faktorët fondametalë, si përmirësimi i bilancit të pagesave, akomodimi i politikave dhe investimet e larta të huaja. Ahmetaj tha se qeveria nuk bën ndërhyrje në kursin e këmbimit dhe do të ishte e gabuar të bëheshin ndërhyrje. Për eksportuesit e fasonëve, Ahmetaj tha që luhatja e kostove nga kursi për ta është e kufizuar nga 2 në 3%, për shkak se ata kanë një vlerë të shtuar të ulët, prej maksimumi 20%. Ai rekomandoi që eksportuesit të shohin më shumë nga produktiviteti dhe jo nga kostot.

**NUMRI I TË PUNËSUARVE**

Krahasuar me janarin 2013, janë 651 mijë të punësuar në bordero, ose 215 mijë vende të reja pune të krijuara në një mandat. Krahasuar me mars 2017, pra me vitin e kaluar, janë 33,410 vende të reja pune, gjithmonë referuar listëpagesës, borderosë së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

**TREGTIA E JASHTME**

Eksportet dhe importet e mallrave janë në rritje të konsiderueshme ndërkohë që, në tremujorin e parë, rritja e eksporteve është 18.8% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017. Importet për tremujorin e parë të vitit 2018 u rritën me 9.6 % dhe ndërkohë brenda rritjes së importeve, rritja e importeve të makinerive dhe pajisjeve është dyshifrore, 15.3 %, që tregon se pulsi ekonomik vazhdon të rrahë me intensitet.

### Kosto rreth 16.2 milionë lekë

## Censi 2020: INSTAT do numërojë popullsinë

Censi i vitit 2020 si shtylla kryesore e sistemit kombëtar të statistikave dhe sfidat e tij kanë qenë temat kryesore të diskutimit në takimin e parë përgatitor të organizuar nga INSTAT në bashkëpunim me Delegacionin e Bashkimit Europian në Shqipëri. Duke qenë se ky është procesi më i rëndësishëm demografik i një vendi, kërkon një përdorim të madh burimesh financiare dhe njerëzore. Nga pikëpamja e efektivitetit të kostos, qëllimi i këtij Censi është të planifikohet dhe të kryhet në një mënyrë sa më pak të kushtueshme, pa kompromentuar objektivat e tjerë strategjikë. Objektivat e Censit 2020 kanë të bëjnë me minimizimin e kostos duke adoptuar qasje dhe teknologji sa më eficiente lidhur me grumbullimin, kapjen dhe procesimin e të dhënave. Në fjalën e saj, drejtoresha e Përgjithshme e INSTAT, Delina Ibrahimaj, u shpreh se zhvillimi ekonomik dhe social i një vendi duhet të mbështetet në vendimmarrje të bazuar në të dhëna të sakta, ndaj dhe prodhimi në kohë dhe me saktësi i statistikave




është thelbësor. "Roli thelbësor i Censit të popullsisë dhe banesave është të mbledhë, përpunojë dhe të shpërndajë të dhëna e detajuara për këto njësi të vogla në lidhje me popullsinë, përbërjen e saj, karakteristikat, shpërhapjen hapësinore dhe organizimin e njësive ekonomike familjare. Roli kryesor i një censi është të prodhojë një numërim të saktë të popullsisë rezidente të një vendi. Ndërsa në terma të administrimit publik, ky numërim është i nevojshëm dhe përdoret në shumë vende për ndarjen e barabartë të fondeve publike apo dhe për organizimin e proceseve zgjedhore", tha Ibrahimaj. I pranishëm në këtë takim, Z. Mario Mariani, Drejtues i Zyrës së Bashkëpunimit pranë Delegacionit të BE në Tiranë, tha se për të lehtësuar dhe shpejtuar procesin e regjistrimit të popullsisë është shumë e rëndësishme të merren masa në përgatitjen e regjistrave dixhitale në sistemin e njësive vendore të qeverisjes. Sipas tij, ky është hapi i parë dhe i duhuri drejt arritjes së qëllimit.



## Qeveria ul shpenzimet për ndihmën ekonomike në tremujorin e parë me 3.8%

Shpenzimet për fondet e ndihmës ekonomike pësuan ulje me 3.8% në tremujorin e parë të 2018 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017 prej skemës së re të shpërndarjes që nëpërmjet një klasifikimi të ri përjashtoi me qindra familje nga skema. Reagimi i familjeve të përjashtuara, një problem i njohur tashmë edhe në opinionin publik, është reflektuar edhe në fondet buxhetore, të cilat kanë rezultuar me kursim gjatë periudhës janar-mars 2018. Sipas të dhënave nga Ministria e Financave, për tremujorin e parë, u shpërndanë si ndihmë ekonomike për familjet e varfëra 4.4 miliardë lekë me një kursim prej më shumë se 1.3 milionë eurosh në krahasim me vitin e kaluar. Aplikimi i sistemit të ri informatik në ndarjen e ndihmës ekonomike ka krijuar konfuzion dhe, në shumë raste, ka përjashtuar shtresat vulnerabile nga kjo ndihmë, e cila edhe për familjet përfituese është shumë më e ulët se minimumi jetik në vend. Problematika u referua në Kuvendin e Shqipërisë nga Avokati i Popullit, sipas të cilit sistemi për përfitimin e ndihmës ekonomike duket se ka krijuar konfuzion dhe shqetësim të madh për qytetarët.

## Mashtrimi me vizat, zbardhen përgjimet e falsifikatorit me policin Arian Uku


Laboratori në të cilin realizohej falsifikimi i dokumenteve

Pas finalizimit të operacionit të koduar "272", ku u shkatërrua një rrjet i mashtrimit me vizat dhe ranë në pranga 41 shtetas, zbulohen detaje të reja lidhur me personat e përfshirë në trafikim. Mësohet se policia dhe prokuroria kanë mbajtur në përgjim telefonik ambien al, por edhe në vëzhgim trafikantët. Ata dyshohet se pajisnin me dokumente identifikimi të falsifikuara kundrejt përfitimit monetar dhe u krijonin kushtet në mënyrë të paligjshme personave të ndryshëm për të udhëtuar drejt SHBA-ve, Kanadasë, Mbretërisë së Bashkuar. Kujtojmë se të ndaluar për këtë ngjarje janë dy punonjës policie, konkretisht Arian Uku inspektor në Seksionin e trafikut interurban në Komisariatin e Policisë Rrugore Tiranë dhe Entela Çala, specialist në Seksionin e Trafiqeve të Paligjshme në DVP Tiranë. Një prej bisedave të përgjuara është ajo e efektivit të Rrugores Arian Uku, me bashkëjetuesin e Entela Çalës, oficeres së Zyrës së trafiqeve në Drejtorinë e Tiranës. Uku i kërkon bashkëjetuesit të Entela Çalës që t'i kryejë dy porositë për të cilat kanë folur. Ky i fundit i përgjigjet pozitivisht, duke i thënë se e ka përmbushur misionin. Pas zbardhjes së komunikimeve të shpeshta mes tyre, policia i ka vënë në pranga. Bëhet me dije se për këtë aktivitet të paligjshëm, grupi merrte nga personat e trafikuar shuma të konsiderueshme të vlerave monetare, që shkonin deri në 20 mijë euro për person. Sakaq, Policia e Shtetit në bashkëpunim të ngushtë me Prokurorinë e Krimeve të Rënda Tiranë po vijon punën për dokumentimin e plotë dhe zbardhjen e gjithë skemës së falsifikimit të dokumenteve dhe trafikimit të qenieve njerëzore.

### Fletorja Zyrtare, Këshilli i Ministrave: Të pasqyrohet sa më qartë performanca e institucioneve

# Miratohet plani i veprimit antikorrupsion për vitet 2018-2020

## *Krijohet grupi i Task Forcës, përgjegjëse për inspektimet*

Ina Allkanjari

**INSTITUCIONET**
Këshilli i Ministrave miratoi planin e veprimit 2018-2020, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit. Në total janë 84 institucione të përfshira në këtë plan, konkretisht 11 ministri, 12 institucione të nivelit qendror dhe 61 bashki.


Foto Illustruese

Me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave miratoi planin e veprimit 2018-2020, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit. "Duke u nisur nga raporti i fundit i Transparency International mbi Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit dhe renditjen e Shqipërisë e 91-ta në listën e 168 vendeve të përzgjedhura për studim, nevojitet një impenjim edhe më i madh në luftën kundër korrupsionit",- thuhet në Fletoren Zyrtare. Për këtë shkak Këshilli i Ministrave vendosi krijimin e Komitetit Koordinator për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, që kryesohet nga ministri i Drejtësisë. Gjithashtu, u vendos krijimi i Task Forcës Ndërinstitucionale Antikorrupsion dhe u përcaktuan tregues të matshëm me qëllim pasqyrimin sa më të qartë të performancës së institucioneve dhe realizimit të objektivave të strategjisë. Për realizimin e punës Task Forca krijon grupe të posaçme inspektimi me specialistë të ministrive ose institucioneve qendrore, të cilët zbatojnë procedurat e kontrollit apo të verifikimit. "Task-Forca harton dhe miraton një program pune si dhe kalendarin e inspektimeve, ku përcaktohen detyra dhe afate konkrete për grupet e posaçme të inspektimit. Kur vlerësohet e përshtatshme, në mbledhjet e Task Forcës mund të marrin pjesë edhe përfaqësues nga institucionet e tjera shtetërore, në veçanti ato që ushtrojnë funksione trajtimi të ankesave, inspektimi, auditimi dhe kontrolli të brendshëm",- thuhet në Fletoren Zyrtare. Më tej në Fletoren Zyrtare theksohet se në përfundim të çdo inspektimi apo kontrolli, nga grupet e posaçme të inspektimit hartohet raporti që do t'i paraqitet Task Forcës Ndërinstitucionale Antikorrupsion, me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse. Task Forca e dërgon raportin pranë titullarëve të institucioneve përkatëse për marrjen e masave të duhura. Sakaq në total janë 84 institucione të përfshira në këtë plan, konkretisht 11 ministri, 12 institucione të nivelit qendror dhe 61 bashki.

**PLANI I VEPRIMIT**

Korrupsioni është një kërcënim për demokracinë, mirëqeverisjen, konkurrencën e ndershme, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, shoqëror dhe politik të një vendi. Ai pengon rëndë zhvillimin ekonomik, duke krijuar një sistem pabarazie, paragjykimi e nepotizmi, duke shkatërruar besimin e njerëzve tek shteti i tyre, prandaj lufta kundër korrupsionit është sot një nga sfidat parësore të çdo shteti me kulturë demokratike, vizion dhe integritet të lartë. Kjo problematikë e bartur ndër vite e mjaft komplekse, është kthyer në një nga çështjet më sensitive për shoqërinë tonë, dhe si e tillë lufta kundër korrupsionit nuk përbën vetëm një prioritet për qeverinë shqiptare, por përbën një nga 5 prioritetet kyçe që Bashkimi Evropian ka vendosur për Shqipërinë në rrugëtimin e saj të integrimit në familjen evropiane. Qeveria ka dhe do vazhdojë në mënyrë të pandalur të ketë një vullnet të palëkundur në luftën kundër korrupsionit, përmes aksioneve parandaluese, masave ndëshkuese dhe aktiviteteve ndërgjegjësuese. Prej vitit 2015 Shqipëria ndjek dhe zbaton Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit. Gjatë trevjeçarit të parë institucionet implementuan masa konkrete antikorrupsion të parashikuara në Planin e Veprimit 2015-2017. Nga Raportet e Monitorimit të hartuara nga KKK-ja u vërejt se 85% e masave të parashikuara në Planin e Veprimit u realizuan plotësisht ose pjesërisht. Për këtë arsye, si dhe duke u nisur nga raporti i fundit i Transparency International mbi Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit dhe renditjen e Shqipërisë e 91-ta në listën e 168 vendeve të përzgjedhura për studim, nevojitet një impenjim edhe më i madh në luftën kundër korrupsionit. Për këtë shkak, KKK-ja në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtar dhe për arritjen e objektivave të parashikuar e vlerësimin e indikatorëve të performancës është hartuar Pasaporta e Indikatorëve në zbatim të SNKK-së, duke shpjeguar metodologjinë e detajuar për kalkulimin e vlerave të baseline dhe target të paraqitura nga institucionet, janë përcaktuar tregues të matshëm me qëllim pasqyrimin sa më të qartë të performancës së institucioneve dhe realizimit të objektivave të strategjisë. Në korrelacion me Pasaportën e Indikatorëve dhe të 37 indikatorëve të performancës, Plani i veprimit 2018-2020, pas një bashkëpunimi të mirë koordinuar me të gjitha institucionet e nivelit qendror dhe vendor, përmban 97 masa konkrete antikorrupsion të ngritura mbi bazë rezultati, performance, impakti, në funksion të 18 objektivave të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit.

STRATI
Shoqëria përmbarimore **"STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k.,** njofton shpalljen për shitjen në ankand të pasurive të paluajtshme:
- Nr. Pasurie Nr. 6/36, Vol. 3, Faqe 137, Zona Kadastrale 1441, Arë me sipërfaqe 2400 m2, me vendndodhje ne Damjan - Tiranë, regjistruar në bashkëpronësi të Z. Ymer Tresa, Zj. Pranvera Tresa, Z. Florenc Tresa, Zj. Laerta Hakcani (Tresa). Çmimi fillestar i ankandit është 2.000.000 Lekë.
Ankandi për pasurinë e mësipërme zhvillohet në datë 23.05.2018.
Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambjentet e Shoqërisë Përmbarimore "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7. Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

STRATI
Shoqëria përmbarimore **"STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k.,** njofton shpalljen për shitjen në ankand të pasurive të paluajtshme:
-"Apartament", me sipërfaqe 243.30 $m^2$, ndodhur në Fier, me Nr. 4/892+1-2 Pasurie, Zona Kadastrale 8533, volumi 22, faqe 228, rregjistruar në pronësi të Z. Adif Llakaj. Çmimi fillestar i ankandit është 54,880 Euro.
Ankandi për pasurinë e mësipërme zhvillohet në datë 23.05.2018.
Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambjentet e Shoqërisë Përmbarimore "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7. Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

**ZYRA PËRMBARIMORE PRIVATE ENIRJETA ZISI**
**Permbaruese gjyqesore private Enirjeta Zisi z**hvillon ankandin per shitjen e pasurise se paluajtshme "Apartamenti" me siperfaqe 92.1m2, ZK.3866, Nr.Pasurie.300/143+1-7,Vol.83,Fq.186,Indeksi i Hartes K-34-100, te ndodhur ne Tirane, Yzberisht prane rruges "Joklin Persi ", kati i 3 ,shk.1 ap.7 Tirane,per shlyerjen e detyrimit ne favor te kreditorit Yzeir Llanaj,
Çmimi fillestar me të cilin fillon ankandi është ne shumen 4.778.400 (kater miljon e shtateqind e shtatedhjete e tete mije e katerqind) leke. e percaktuar ne vendimin gjyqesor.
**Ankandi zhvillohet ne date 20.04.2018, ora 16.00 ne zyren e Permbarueses gjyqesore private Enirjeta Zisi, Bulevardi "Gjergj Fishta", Pallati "Gora"Kulla.2,Kati i 2, Tirane Nr.Tel. 0694799000, email:enirjeta.zisi@gmail.com**

Shëndetësi

> Disa nga simptomat kryesore të kolitit janë diarre ose kapsllëk, gjakderdhje në jashtëqitje, fryrje e dhimbje e zorrëve; mostretje e ushqimit, anemi, hemorroide në fund të zorrës së trashë. **Glikoja e arrës shërben si antibiotik natyral pasi përmban jod dhe e mjekon zorrën nga brenda dhe ndihmon në mbylljen e plagëve të brendshme.**



Mjeku popullor: Antibiotikët dhe kontraceptivët, faktorë në shfaqjen e kolitit

Voltiza Duro

# YLLI MERJA: Përdorni vajin e mendrës për kurimin e inflamacionit në zorrën e trashë

## *"Kujdes nga ushqimet e thata, limitoni yndyrat"*

Koliti është një sëmundje inflamatore e zorrës së trashë. Inflamacioni është skuqje dhe acarim i mukozës së zorrës nga brenda, e cila pengon thithjen e të gjitha vlerave të ushqimit nga zorrët. Fryrja e zorrëve në brendësi krijon probleme me lëvizjen e masës dhe kështu shkakton kapsllëk dhe hemorroide, ose dalje të zorrës nga jashtë në pjesën e anusit. Gjithashtu, në rastet e rënda shkakton diarre të shpeshtë me gjakderdhje, kur zorra nuk ka aftësi thithëse. Koliti është një sëmundje 100% e kurueshme. Nëse trajtohet në kohë, atëherë shërohet shumë lehtë e vlen të theksoj se kjo sëmundje prek më shumë meshkujt se femrat, si dhe grupmoshat nga 14-40 vjeç. Shumë persona në vendin tonë, veçanërisht meshkujt, kanë probleme me kolitin e shpeshherë nuk arrijnë të kurohen plotësisht. Ushqimet e thata, të yndyrshme dhe jeta sedentare bën që të shfaqet kjo sëmundje inflamatore në zorrën e trashë.

**SHKAKTARËT**

Koliti shkaktohet nga kequshqyerja, përdorimi i ushqimeve të thata, me shumë yndyrë dhe ushqimeve 'fast food'. Një shkak tjetër është stresi ose jeta sedentare. Gjithashtu, sistemi imunitar është një faktor tjetër ndikues. Inflamacioni në zorrë shkaktohet nga sulmimi i sistemit imunitar me mukozën e brendshme të organizmit. Pra, kur organizmi sulmon vetveten, sepse sistemi imunitar është më aktiv se norma. Gjithashtu, koliti është sëmundje e trashëguar në familje. Nëse prindërit vuajnë nga koliti, mundësia që fëmijët të preken nga sëmundja është e lartë. Edhe përdorimi i ilaçeve si antibiotikët, kontraceptivët, shkaktojnë kolit, pasi antibiotikët shkatërrojnë florën bakteriale të zorrës së trashë, prandaj duhen evituar sa më shumë.



Mjeku popullor Ylli Merja

**SIMPTOMAT**

Disa nga simptomat kryesore të kolitit janë diarre ose kapsllëk, gjakderdhje në jashtëqitje, fryrje e dhimbje e zorrëve; mostretje e ushqimit, anemi, hemorroide në fund të zorrës së trashë.

**TRAJTIMI**

Për të gjithë të sëmurët me kolit rekomandohet konsumimi i një vaji esencial mendre dhe borziloku si dhe përdorimi i xhinxherit në gjellë. Kombinimet bimore për kolitin përmbajnë bimë, të cilat ndalojnë inflamacionin dhe kurojnë sëmundjen. Gjithashtu, glikoja e arrës shërben si antibiotik natyral pasi përmban jod dhe e mjekon zorrën nga brenda dhe ndihmon në mbylljen e plagëve të brendshme. Aloe vera xhel është shumë i domosdoshëm për të kuruar kolitin. Edhe curcumina që gjendet tek turmeriku ndihmon në sëmundjet inflamatore dhe forcon sistemin imunitar, pasi është një antioksidant i fuqishëm. Frankincense është, gjithashtu, shumë i domosdoshëm, pasi ndalon reaksionet kimike në organizëm që prodhojnë stimulantë për inflamacionin. Më tej edhe mjalti shërben si lubrifikues i zorrës, pasi ul inflamacionin dhe nxit përthithjen e antioksidantëve nga organizmi.



> Rekomandohet të konsumohen 2 litra ujë në ditë, peshk pasi përmban omega3 dhe kjo ndihmon në uljen e inflamacionit, 1 banane në ditë, lulelakër si dhe brokoli. Rekomandohet përdorimi i arrave, bajameve, farave të lirit të shtypura dhe fara chia, pasi përmbajnë acide yndyrore, të cilat ushqejnë dhe rigjenerojnë zorrën e kanë veti antiinflamatore.

**DIETA USHQIMORE**

Të gjithë pacientëve që vuajnë nga kjo sëmundje u rekomandohet të konsumojnë fruta me tul dhe perime jeshile. Gjithashtu, duhet të bëjnë kujdes që të mos shtojnë në peshë e të mundohen të largojnë stresin e të bëjnë një gjumë sa më të qetë e të plotë. Më tej këshillohet që të prekurit nga koliti të përmirësojnë punën e sistemit imunitar duke përdorur bimë medicinale, të cilat ndihmojnë në këtë si dhe të marrin vitaminën C. Gjithashtu, rekomandohet të konsumohen 2 litra ujë në ditë, peshk pasi përmban omega3 dhe kjo ndihmon në uljen e inflamacionit, 1 banane në ditë, lulelakër si dhe brokoli. Rekomandohet përdorimi i arrave, bajameve, farave të lirit të shtypura dhe fara chia, pasi përmbajnë acide yndyrore, të cilat ushqejnë dhe rigjenerojnë zorrën e kanë veti antiinflamatore. Ushqimet që duhen përdorur në sasi të kufizuara nëse nuk vuani nga koliti dhe ato që nuk duhen përdorur fare në periudhën e zorrës së inflamuar janë: kafja (kafja nxit jashtëqitjen); alkooli (nxit diarrenë); produktet e qumështit (rritin bakteret në zorrë); fasulet (shkaktojnë shumë gazra dhe fryrje të mëtejshme të zorrës). Gjithashtu, duhet evituar përdorimi i mishit, pasi ky i fundit kërkon një zorrë të shëndetshme për t'u tretur; misrave, sheqernave e ëmbëlsirave. Edhe ushqimet pikante shkaktojnë diarre, fryrje të zorrëve dhe rritje të inflamacionit, prandaj duhen eliminuar nga tryeza.

"Kujdes, verifikoni saktë të dhënat e aplikimit fillestar, mund t'ju refuzohet viza"

# Hapat që duhet të ndjekin fituesit e Lotarisë Amerikane për tokën e premtuar

## *Ambasada: Ja dy faktorët që përcaktojnë datën e intervistës*

Voltiza Duro

Dy ditë më parë të gjithë ata që aplikuan për Lotarinë Amerikane kanë pasur mundësinë të kontrollojnë nëse janë përzgjedhur ose jo. Kandidatët për të parë përgjigjet përfundimtare duhet të vendosnin në përdorim numrin e tyre unik të konfirmimit të dhënë në regjistrim, duke kontrolluar online Kontrollin e Statusit të të Regjistruarve. "Gazeta Shqiptare" publikon sot të gjitha hapat që duhet të ndjekin fituesit për të jetuar e punuar në "tokën e premtuar", në një kohë që ambasada amerikane bën me dije se të përzgjedhurit do të informohen nga vetë autoritetet për ditën e nisjes së procedurave të vizës.

### HAPAT PAS PËRZGJEDHJES

"Vetëm pasi ju të jeni përzgjedhur, pasi t'u jeni përgjigjur udhëzimeve të njoftimit të mundësuar për ju nëpërmjet Kontrollit të Statusit të Aplikimit, si dhe pasi të ketë filluar shqyrtimi i rastit tuaj, vetëm atëherë ju mund të merrni në vazhdim e-maile komunikimi nga QKK-ja që ju njofton juve të shikoni Kontrollin e Statusit të Aplikimit për informacione të reja rreth aplikimit tuaj",-theksohet në faqen zyrtare të ambasadës. Në këtë të fundit më tej bëhet me dije se të përzgjedhurit e programit DV-2018, duhet të plotësojnë formularin elektronik DS-260 e sa më herët ta bëjnë këtë, aq më shpejt do të kenë mundësinë e caktimit të datës së intervistës për vizë. Caktimi i datës së intervistës varet nga dy faktorë: numri i fituesit (sa më i ulët të jetë aq më shpejt caktohet intervista) dhe plotësimi i formularit DS-260 që gjendet në faqen e internetit të Qendrës së Aplikimeve Elektronike Konsullore.



**RASTET E REFUZIMIT**
Mosdeklarimi i bashkëshortit/es ekzistues, apo i fëmijës ekzistues në momentin e aplikimit fillestar për lotarinë do të rezultojnë në refuzimin e vizës për fituesin, gjithashtu. Çdo tarifë e paguar ndaj qeverisë së Shteteve të Bashkuara për aplikimin për vizë nuk rimbursohet.

### VERIFIKIMI I TË DHËNAVE

Përpara intervistës për vizë, rekomandohet rishikimi i të dhënave që fituesi ka dhënë në aplikimin e tij fillestar për lotarinë. "Sigurohuni që të keni dhënë informacionin e saktë mbi statusin tuaj civil në momentin e aplikimit fillestar. Nëse ju ishit i/e martuar në momentin e aplikimit fillestar për lotarinë, ju duhet të kishit përfshirë bashkëshortin/en tuaj në atë aplikim fillestar (edhe nëse keni qenë në proces divorci)",-thekson ambasada amerikane. Më tej kjo e fundit nënvizon se përjashtim bëjnë rastet kur bashkëshorti është nënshtetas amerikan, ose banor i përhershëm i ligjshëm. Gjithashtu, aplikantët duhej të kishin përfshirë të gjithë fëmijët të pamartuar dhe nën 21 vjeç në momentin e aplikimit fillestar. Me fëmijë nënkuptohen fëmijët biologjikë, dhe thjeshtërit- fëmijët e bashkëshortit/es, apo fëmijë që janë ligjërisht, pavarësisht nëse jetojnë me fituesin ose jo. Gjithashtu, fituesit duhet të sigurohen që kanë ngarkuar fotografinë e saktë për çdo pjesëtar të familjes në momentin e aplikimit fillestar për lotarinë pasi ngatërrimi i fotografive në aplikimin fillestar do të rezultojnë në refuzimin e vizës për aplikantin dhe familjen e tij. Mosdeklarimi i bashkëshortit/es ekzistues, apo i fëmijës ekzistues në momentin e aplikimit fillestar për lotarinë do të rezultojnë në refuzimin e vizës për fituesin gjithashtu. Çdo tarifë e paguar ndaj qeverisë së Shteteve të Bashkuara për aplikimin për vizë nuk rimbursohet. "Nëse në momentin e aplikimit fillestar, ju nuk keni përfshirë një fëmijë ekzistues, apo një bashkëshort/e me të cilën ishit i martuar (pra, statusi juaj civil ishte "i martuar" në momentin e aplikimit fillestar), atëherë mos vazhdoni me procedurën e aplikimit për vizë."-thekson më tej ambasada.



**Njoftimi**

**MESAZHET "MASHTRUESE"**
"Nëse ju keni marrë një postë elektronike (e-mail) që ju njofton se aplikimi juaj për programin e Lotarisë Amerikane ishte fitues dhe në mënyrë që të vazhdoni me aplikimin tuaj ju duhet të dërgoni një shumë të hollash (para) në emër të një personi, ju jeni viktimë e një mashtrimi", - thuhet në faqen zyrtare të ambasadës amerikane.

### MESAZHE MASHTRIMI

"Nëse ju keni marrë një postë elektronike (e-mail) që ju njofton se aplikimi juaj për programin e Lotarisë Amerikane ishte fitues dhe në mënyrë që të vazhdoni me aplikimin tuaj ju duhet të dërgoni një shumë të hollash (para) në emër të një personi, ju jeni viktimë e një mashtrimi",-thuhet në faqen zyrtare të ambasadës amerikane. Vitet e shkuara, aplikantët fitues njoftoheshin nga Departamenti i Shtetit, Qendra Konsullore në Kentucky (QKK) me anë të postës, JO me e-mail dhe të përzgjedhurve u jepeshin udhëzimet se si të vazhdonin në hapat e mëtejshëm të procesit. QKK-ja nuk ju kërkon aplikantëve që të dërgojnë para atyre, apo ndonjë ambasade tjetër të Shteteve të Bashkuara të Amerikës me postë apo nëpërmjet shërbimeve si Western Union. Për ata që kanë aplikuar për DV-2019, njoftimi zyrtar i përzgjedhjes do të kryhet drejtpërdrejt nëpërmjet Kontrollit të Statusit të Aplikimit. Kjo është e vetmja mënyrë me të cilën do të marrin njoftim të statusit të aplikimit kandidatët.


NJOFTIM

albprogres
SHOQERI KURSIM KREDITI

Njoftohen anëtarët e shoqërisë (asamblesë) kursim kreditit ALB-Progres se më dt 18 (tetëmbëdhjetë) Maj 2018,ora 10.00 ne bashkinë Elbasan,Lokali Benvenuto, zhvillohet Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë,(nëse mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme nuk mund të realizohet për shkak të mungesës së kuorumit, Asambleja e Pergjithshme mblidhet përsëri brenda ditës së nesërme po në të njëjtin vend me të njëtën rend dite dhe orar, pra më dt.19 (nëntëmbëdhjetë) Maj 2018 ora 10.00) me rend dite si vijon:

1. Miratimin e raportit të aktivitetit të Këshillit Drejtues për vitin 2017.
2. Miratimin e raportit të aktivitetit të Komitetit te Kontrollit për vitin 2017.
3. Miratimin e raportit të aktivitetit të Administratorit për vitin 2017.
4. Miratimi i pasqyrave financiare dhe bilanci financiar i shoqërisë dt.31/12/2017.
5. Miratimi i përdorimit të tepricës neto vjetore dhe ndarjes së rezultatit për vitin 2017.
6. Miratimi i buxhetit të shoqerisë për vitin 2018.
7. Ndryshimi/Zëvendësimi I njërit prej anëtarëve të Këshillit Drejtues të Shoqërisë.
8. Zgjedhja e një audituesi të ri ligjor sipas kërkesave të ligjit nr 52/2016 dt 19.05.2016.
9. Ndryshimin e kuotës së anëtarësimit në shoqëri për anëtarët e shoqërisë në 500 (pesëqind) Lekë.
10. Miratimin e shpërblimeve për organet drejruese të shoqërisë për vtin 2018.
11. Të ndryshme.

Për më shumë informacion kontaktoni në: **T** 054 253099 **E** info@albprogres.org

KËSHIILLI DREJTUES

Lagjja Luigj Gurakuqi, Pall 73, Ap 1, Kati 1, Elbasan
T 054 253099 E info@albprogres.org



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerja e suportit vjetor te produkteve Cissco"**

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 4,671,000 Lekë"**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkese me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "**Blerja e suportit vjetor te produkteve Cissco"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 07 Qershor 2018, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

### Luis Alban Ziko shfaq performancën më të lartë

# Konkursi për programuesit e rinj, tre nxënës të "Harry Fultz" rrëmbejnë çmimet

Për të dytin vit radhazi, 16 nxënës të shkollës Harry Fultz morën pjesë në konkursin "Këndi i programuesve të rinj", të organizuar nga Departamenti i Informatikës, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, në Universitetin e Tiranës. Gjatë konkurrimit 9 prej tyre kaluan me sukses në fazën finale e madje 3 nxënës u shpallën fitues. Përkatësisht nxënësi Kleition Bendo arriti vendin e tretë, Daniel Stefani u rendit në vendin e dytë ndërsa i riu Luis Alban Ziko arriti të rrëmbente vendin e parë si fitues i çmimit special ofruar nga Albetelecom. Ziko rezultoi si nxënësi me performancë më të lartë dhe kohë më të shkurtër për zhvillimin e testimit.

**KONKURSI**

Përgatitja e të rinjve për një të ardhme digjitale ishte qëllimi kryesor i konkursit. Falë teknologjisë, nxënës të 14 gjimnazeve morën pjesë në konkurs, duke kryer zhvillime nga shtëpitë e tyre. Kohëzgjatja e aplikimit përmes platformës "Young Programmers Space" ishte mes datave 20 prill dhe 12 maj 2018, në formën e një konkursi midis nxënësve të shkollave të mesme. Qëllimi kryesor i këtij konkurrimi është ofrimi i mundësive për nxënësit e shkollave të mesme të testojnë aftësitë e tyre në gjuhë të ndryshme të programimit. Nxënësit, gjithashtu, krijojnë një qasje më konkrete ndaj universitetit dhe kuptojnë më mirë degët që mund të ndjekin në të ardhmen. Çmimin ALBtelecom, që ishte edhe çmimi i parë i këtij konkursi e fitoi Luis Alban Ziko, nxënës i vitit të katërt, të shkollës së mesme "Harry Fultz", i cili fitoi një vit internet falas dhe shërbim ALBtv në shtëpinë e tij, ofruar nga kjo kompani. Ndërkohë vlen të theksohet se vitin e kaluar, "Harry Fultz", u përfaqësua me 20 nxënës nga të cilët 6 morën çmime; respektivisht 2 vende të treta, 2 të dyta si dhe 2 vende të para.



### Dokumentacioni që duhet të dorëzoni brenda 1 qershorit të këtij viti

# Bursa në Poloni për studentët e Fakultetit të Ekonomisë

## *Fituesit, kompensim prej 750 eurosh në muaj*

Voltiza Duro

Studentët e Fakultetit të Ekonomisë në Universitetin e Tiranës kanë afat deri në 1 qershor të këtij viti për të aplikuar për bursa në Universitetin Sileasian të Teknologjisë në Poloni. Kështu të gjithë të interesuarit që do të kandidojnë e do të shpallen fitues do të kenë mundësinë të zhvillojnë një semestër në këtë universitet në nivelin bachelor, master si dhe doktoraturë. Bursat që do të jepen për fituesit do të përfshijnë kompensimin mujor prej 750 eurosh në muaj për secilin student si dhe mbulimin e kostove të udhëtimit në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës. "Studenti duhet të kryejë brenda afatit të përcaktuar regjistrimin online dhe të informohet për dokumentacionin e kërkuar. Gjithashtu, dokumentacioni duhet të sillet dorazi edhe në Sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë në Rektoratin e Universitetit të Tiranës",-bëhet me dije në faqen zyrtare të Fakultetit të Ekonomisë. Të gjithë të interesuarit për nivelin Bachelor duhet të dorëzojnë brenda afatit të përcaktuar një cv në gjuhën angleze; kopjen e pasaportës; vërtetim studenti të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze; listën e notave; një letër motivimi në gjuhën angleze, certifikatën e gjuhës së huaj anglisht në nivelin B1 si dhe kontratën Learning Agreement.



**MASTER DHE DOKTORATURË**

Studentët që do të aplikojnë për studime në nivelin master, krahas dokumentacionit të sipërpërmendur duhet të dorëzojnë edhe një diplomë dhe listë notash të bachelor-it të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze. Ndërkohë kandidatët për bursa studimi në doktoraturë duhet të dorëzojnë edhe diplomën e listën e notave për këtë cikël studimesh. "Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin Sileasian të Teknologjisë lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e parë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillonit në fakultetin tuaj, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloni/frekuentoni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës",-theksohet në njoftim.

### DOKUMENTACIONI

**Niveli bachelor:**
- CV (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);
- Listë notash (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);
- Letër Motivimi në gjuhën angleze;
- Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht B1);
- *Learning Agreement;

**Niveli master:**
- CV (në gjuhën anglez);
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);
- Listë notash (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);
- Letër Motivimi në gjuhën angleze;
- Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht B1);
- Diplomë dhe listë notash të Bachelor-it (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);
- *Learning Agreement;

**Niveli doktoraturë:**
- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti (të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën Angleze);
- Diplomë Bachelor;
- Listë notash Bachelor (të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën Angleze);
- Diplomë Master (të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën Angleze) ;
- Listë notash Master (të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën Angleze);
- Letër motivimi (në gjuhën angleze)
- Certifikata e gjuhës së huaj (niveli B1)
- Dokumenti Learning Agreement*

EPSA enforcement private service

**SHOQËRIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A"**
**SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PER:**

1. **Are** me nr.33/26, e ndodhur ne Karpen, Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.2099,vol.11, fq.202, me sip.2,000 m2, cmimi që do të shitet është **3.548.664** lekë.
2. **Are** dhe truall me **nr.1/88**, e ndodhur ne Qerret, Kavaje, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.3101, vol.9, fq.34, me sip.1,770 m2 cmimi që do të shitet është **8.793.590** lekë.
3. **Are** me nr.33/27, e ndodhur ne Karpen. Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.2099, vol.1, fq.203, me sip.4,050 m2 cmimi që do të shitet është **7.186.045** lekë.
4. **Are** me nr.70/9, e ndodhur ne Qerret, Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.3101, vol.2, fq.106, me sip.6,460 m2 cmimi që do të shitet është **4.584.875** lekë.
5. **Njësi** me nr.15/22+1-N1 e ndodhur ne Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.8551, nr.rregjistri hipotekor 14/69, vl.2011, datë 03.03.2011 me sip.116 m2 vlerësohet me vlerën e **9.056.191** lekë.
6. **Njësi** me nr.15/22+1-N2 e ndodhur ne Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.8551, nr.rregjistri hipotekor 14/70, vl.2011, datë 03.03.2011 me sip.91 m2 vlerësohet me vlerën e **7.104.426** lekë.
7. **Njësi** me nr.15/22+1-N3 e ndodhur ne Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.8551,nr.rregjistri hipotekor 15/71, vl.2011, datë 03.03.2011 me sip.95 m2 vlerësohet me vlerën e **7.416.708** lekë.
8. **Njësi** me nr.15/22+1-N4 e ndodhur ne Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.8551,nr.rregjistri hipotekor 15/72, vl.2011, datë 03.03.2011 me sip.211 m2 vlerësohet me vlerën e **16.472.899** lekë.
9. **Bodrum** me nr.15/22+1-B e ndodhur ne Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.8551, nr.rregjistri hipotekor 130/176, vl.2005-2007, datë 24.09.2007 me sip.609 m2 vlerësohet me vlerën e **13.261.358** lekë.Te gjitha pasurite e sipërcituara jane hipotekuar në favor te **Banka Raiffeisen sha.** Prsh Casa Nostra.

Ankandi zhvillohet ne **datë 11.06.2018 ora 16.00** në adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratari", K.6,Tirane. Per cdo informacion kontaktoni ne tel. 04 2262711 ose ne www.epsa.al

**Dosja, nën akuzë edhe 4 inspektorët e AKU-së në Shkodër**

# Skandali me pijet, prokuroria çon për gjykim pronarin e firmës, Xhavit Kasemin dhe 3 punonjës



**SHKODËR** - Prokuroria e Shkodrës ka përfunduar hetimet dhe ka dërguar për gjykim një prej çështjeve më të bujshme të saj, duke marrë si të pandehur 9 persona, ku 8 prej tyre janë persona fizikë dhe 1 person juridik. Pas shfaqjes së pamjeve filmike nga emisioni investigativ "Stop" dhe denoncimeve të shumta për një periudhë prej 8 muajsh janë kryer hetime në lidhje me prodhimin e kundraligjshëm të produkteve ushqimore nga shoqëria "Briland" shpk me administrator Xhavit Kasemin. Pas hetimeve, ka rezultuar se kjo shoqëri prodhonte pije të ndryshme alkoolike dhe joalkoolike, si dhe produkte të tjera ushqimore jashtë çdo lloj standardi, në kushte higjieno-sanitare të papërshtatshme, duke rrezikuar kështu shëndetin dhe jetën e konsumatorëve. Për muaj me radhë shoqëria është kontrolluar nga inspektorët e AKU-së, Shkodër, të cilët në kundërshtim me ligjin e kanë paraqitur situatën dhe ambientin si të përshtatshëm për prodhimin e produkteve ushqimore, duke mos konstatuar asnjë shkelje. Prokuroria nëpërmjet një kërkese prej 55 faqesh ka çuar për gjykim çështjen penale në ngarkim të Xhavit Kasemit, i cili akuzohet për veprat penale "Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale", "Prodhimi i kundërligjshëm i artikujve dhe mallrave industrialë dhe ushqimorë", "Fshehja e të ardhurave" dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" e të shoqërisë së tij "Briland" shpk., akuzar për kryerjen e veprave penale "Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale", "Prodhimi i kundërligjshëm i artikujve dhe mallrave industrialë dhe ushqimorë" dhe "Fshehja e të ardhurave". Në dosjen në fjalë janë vënë nën akuzë dhe punonjësit e shoqërisë: Syrri Çaku, Fatjon Bushati dhe Sami Haxhija. Ata akuzohen për "Prodhimi i kundërligjshëm i artikujve dhe mallrave industrialë dhe ushqimorë". Gjithashtu, janë nën akuzë dhe inspektorët e AKU të Shkodrës: Abdyl Bajraktari, Edmond Fortuzi, Elvis Raboshta dhe Hilmi Erkoçaj. Këta të fundit akuzohen për veprën penale "Shpërdorim detyre" në bashkëpunim. **se.ni.**

Ngjarja në tetor të vitit 2016, pas sherrit për lojën e pokerit në lokal

# Masakra e Dajçit me 2 të vrarë dhe 4 të plagosur, burg përjetë 35-vjeçarit

## Miklovan Parubi: Isha i droguar, mora në qafë shumë familje

Senad Nikshiqi

**SHKODËR**

Gjykata e Shkallës së Parë Shkodër ka dënuar me burgim të përjetshëm 35-vjeçarin Miklovan Parubi, i cili akuzohet si autor i masakrës së 3 tetorit të vitit 2016, që ndodhi në një lokal në Dajç. Pas sherrit për lojën e pokerit, ai ekzekutoi me kallashnikov dy persona si dhe plagosi katër të tjerë. Parubi u dënua për veprat penale "Vrasje në rrethana cilësuese, e kryer në bashkëpunim", "Vrasje në rrethana cilësuese e mbetur në tentativë e kryer në bashkëpunim", "Armëmbajtje pa leje" dhe "Prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike". Pas një sërë seancash gjyqësore, togat e zeza të qytetit verior pranuan kërkesën e organit të akuzës që përfaqësohej nga prokurori i çështjes, Vat Staka. Ndërsa për shtetasin e dyshuar si bashkëpunëtor në kryerjen e krimit, Marçel Shpijati, gjykata vendosi dënimin me 3 vite burg, duke ndryshuar veprën penale nga "Vrasje me dashje e kryer në bashkëpunim" në "Moskallëzim të krimit". Gjatë seancës gjyqësore, autori i ngjarjes së rëndë u shpreh: "Unë nuk e di se pse e bëra, pasi të gjithë personat i kam shokë jete. Kam qenë i dehur dhe kam konsumuar hashash. Kam marrë në qafë shumë familje dhe familjen time. Nuk kërkoj asgjë, vetëm drejtësi. Po ju lutem Marçelin mos e merrni në qafë, sepse ai s'ka lidhje me këtë ngjarje". Ndërkaq, avokatja mbrojtëse Kristina Marku ka kërkuar ndryshimin e veprës penale nga "Vrasje në rrethana cilësuese e kryer në bashkëpunim" në "Vrasje në kushtet e tronditjes së rëndë psikike", ndërsa për veprën penale "Plagosje në rrethana cilësuese e mbetur në tentativë", në "Plagosje e lehtë me dashje". Nga ana tjetër, Blerim Bazhdari, avokati i shtetasit Marçel Shpijati, i cili akuzohet si bashkëpunëtor në këtë vepër penale, ka kërkuar ndryshimin e masës së sigurisë për klientin e tij. Sipas mbrojtjes, Shpijati nuk ka pasur dijeni për planin e Parubit dhe se gjatë gjithë kohës ky shtetas ka bashkëpunuar me policinë, duke u vetëdorëzuar dhe duke sqaruar gjitha rrethanat e ngjarjes. Mbrojtja ka kërkuar që të bëhet ndryshimi i veprës penale nga "Vrasje në rrethana cilësuese e kryer në bashkëpunim" në "Moskallëzim të krimit", kërkesë e cila u pranua nga gjykata. Prokurori i çështjes, Vat Staka, në fjalën e tij ka kërkuar dënimin me burgim të përjetshëm për Miklovan Parubin, ndërsa për Marçel Shpijatin dënimin me 20 vite burg. Gjykata pasi ka administruar provat, ka lënë në fuqi kërkesën e prokurorit Vat Staka për autorin e ngjarjes, si dhe ka miratuar kërkesën e avokatit Blerim Bazhdari në ndryshimin e veprës penale për Marçel Shpijatin.



Autori i masakrës, Miklovan Parubi

**NGJARJA**

| 5409 | 30-12-2014 | Gjirokastër | Feim Zaçe | 2,553,657 |
| 97 | 01-01-1998 | Gjirokastër | Muharrem Canaj | 1,246,347 |
| 99 | 01-01-1998 | Gjirokastër | Qamile Brahim Bilaj | 117,341 |
| 320 | 31-05-1996 | Korçë | Zarife Jahollari | 540,707 |
| 1511 | 01-01-1901 | Korçë | Kujtim Pepelloshi | |
| 110 | 05-04-1996 | Shkodër | Avdi Neziri | 2,080,322 |
| 42 | 05-03-1996 | Shkodër | Riza Ymeri | 430,836 |
| 394 | 18-11-1993 | Shkodër | Hashim Nehani | 3,300,210 |
| 100 | 01-01-1998 | Gjirokastër | Deko Tusha | 243,268 |
| 101 | 01-01-1998 | Gjirokastër | Hasime Ballajxhiaj | 512,033 |
| 80 | 01-01-1996 | Elbasan | Bashkim Çela | 780,121 |
| 112 | 01-01-1901 | Dibër | Aziz Lokja | 853,000 |
| 102 | 01-01-1998 | Gjirokastër | Muhamet Bedo Fejzo | 1,870,613 |
| 243 | 01-07-1966 | Tiranë | BAJRAM GJELDIU | 62,564 |
| 20 | 08-02-1996 | Tiranë | DELI KARAJ | 155,630 |
| 77 | 07-06-1995 | Fier | Adem Brahimaj | 886,291 |

DIALOGU
NGERÇI

Komisioneri Hahn: Hapi tjetër, normalizimi i plotë nga të dyja palët

# Ndryshimi i dialogut të Brukselit kthen procesin e marrëveshjes

## *Ngërçi gjeopolitik i Ballkanit, s'mjafton ndërhyrja e SHBA-ve*





**JOHANNES HAHN**
"Hapi tjetër është për të ngritur normalizimin në një nivel të plotë dhe nga të dyja palët. Me ndihmën e Federica Mogherinit të definohet marrëveshja me përmbajte ligjërisht obliguese", ka thënë komisioneri evropain, Johannes Hahn.

Një ndryshim i formatit të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në Bruksel do ta kthente procesin prapa, vlerësojnë njohësit e zhvillimeve politike në Kosovë. Dialogu i deritashëm në Bruksel, për formatin e të cilit që në fillim ishin pajtuar të dyja vendet, është zhvilluar me lehtësimin e Bashkimit Evropian dhe me mbështetjen e fuqishme nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Por së fundmi, për liderët e Kosovës, roli i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në këtë dialog është të vlerësuar i pamjaftueshëm. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj kanë kërkuar përfshirjen aktive të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në dialogun e Brukselit. Politologu Ramush Tahiri thotë për Radion "Evropa e Lirë" se përfshirja eventuale në dialog, në mënyrë aktive e aktorëve të tjerë përveç Bashkimit Evropian, do të nënkuptonte ndryshim të formatit të dialogut të deritashëm në Bruksel. Rrjedhimisht, sipas tij, procesi do të kthehej prapa. "Pala kosovare ka kërkuar që të kyçen Shtetet e Bashkuara të Amerikës, gjë që duket krejtësisht një kërkesë normale, si një lloj garancie. Por, gjithashtu pala serbe ka kërkuar që të kyçet Rusia e që nga pikëpamja e tyre do të dukej në kuadër të një balance. Mirëpo, problemi kthehet në gjenezën e tij. Unë mendoj që fuqitë e mëdha kanë politikën e vet strategjike dhe gjeopolitike, pavarësisht kërkesave të shteteve të vogla, në këtë rast të Kosovës ose edhe të Serbisë", theksoi Tahiri. Ilir Ibrahimi, analist i çështjeve politike, duke folur për Radion "Evropa e Lirë" shpreh mendimin se Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë të përfshira në dialog, me vetë mbështetjen që i kanë dhënë atij. Sipas tij, kërkesa e autoriteteve të Kosovës që roli i SHBA-ve të jetë aktiv në dialog dhe gjithashtu kërkesa e autoriteteve të Serbisë që në dialog të kyçet edhe Rusia, e kthejnë procesin prapa. "Besoj që Bashkimit Evropian i është besuar roli që të përmbyllë këtë proces të dialogut dhe Bashkimi Evropian, në këtë rast e përfaqësuar nga zonja Federica Mogherini, e ka përkrahjen e fuqishme, si nga shtetet e Bashkimit Evropian, sidomos ato që e kanë njohur Kosovën, por edhe nga Shtetet e Bashkuara. Prandaj çdo ndryshim i kompozimit të pjesëmarrësve në dialog tani besoj që nuk është në favor të Kosovës, sepse në momentin që futet edhe Rusia në këtë lojë, atëherë e kemi një rol tjetër të dialogut. Kjo nuk do të shkonte në favor të Kosovës. Prandaj edhe e kemi parë që Shtetet e Bashkuara nuk kanë qenë në favor të përfshirjes aktive në dialog", tha Ibrahimi. Në anën tjetër, që në nismën e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Bashkimi Evropian nuk ka marrë mbi vete barrën që të jetë shpjegues apo interpretues i marrëveshjeve që dalin nga dialogu, por vetëm lehtësues i tij. Njohësit e zhvillimeve politike vlerësojnë se kjo ka bërë që palët e përfshira në dialog, jo rrallë t'i interpretojnë ndryshe nga njëra-tjetra marrëveshjet dhe të mos pajtohen lidhur me to. Një situatë e tillë, sipas politologut Tahiri, e shpjegon edhe insistimin e autoriteteve të Kosovës për përfshirjen aktive të SHBA-ve në dialog, kur tashmë është paralajmëruar se duhet të përmbyllet me një marrëveshje juridikisht obliguese për palët. Por, sipas tij, ky dialog nuk e ka formatin e një konference ndërkombëtare për Kosovën. "Nuk është konferencë ndërkombëtare dhe nuk mund të këtë garantues ndërkombëtar, i cili e imponon zbatimin (e marrëveshjes). Duhet të kemi një lloj dialogu apo bashkëbisedimi me Serbinë, për pranimin në fund të shtetit të Kosovës. Kosova e ka këtë qëllim dhe proceset nuk kthehen prapa. Me Serbinë do të ishte më mirë që çështjet t'i zgjidhnim ashtu si i zgjidhim me Maqedoninë, me Shqipërinë dhe me të gjitha shtetet tjera dhe jo të hyjmë në një status të veçantë të bisedimeve, që është më pak se sa pozicioni i shtetit të Kosovës", theksoi Tahiri. Por, analisti Ibrahimi thekson që në rast se marrëveshja përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, ligjërisht obliguese, do të interpretohej në dy mënyra, atëherë ajo nuk do të konsiderohej fare si marrëveshje. "Nuk besoj që ky është objektivi i Bashkimit Evropian dhe i Shteteve të Bashkuara. Prandaj kjo marrëveshje, e cila synohet të arrihet deri në fund të vitit, do të jetë e qartë dhe do të çojë drejt normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës. Nuk besoj që do të lejohen ambiguitete të tilla. Nuk është në interesin e vendeve që po insistojnë që të kemi një zgjidhje në këtë dialog. Kjo marrëveshje do të këtë një garanci, qoftë nga Bashkimi Evropian, por edhe nga Shtetet e Bashkuara dhe e fuqishme si Gjermania", u shpreh Ibrahimi. Sidoqoftë, pavarësisht se në disa raste autoritetet e të dyja vendeve, të Kosovës dhe Serbisë kanë deklaruar se një marrëveshje ligjërisht obliguese do të duhej të arrihej deri në fund të këtij viti ose në fillim të vitit të ardhshëm, të dyja palët vazhdojnë të mbajnë qëndrime skajshmërisht të kundërta lidhur me zgjidhjen e problemeve që do të çonin në normalizimin e tërësishëm të marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve. Nga ana tjetër, komisioneri Evropian për Zgjerimin dhe Politikën e Fqinjësisë, Johannes Hahn, beson se zgjidhja afatgjatë për normalizimin e marrëdhënieve mes Serbisë dhe Kosovës nënkupton zgjidhje të qëndrueshme dhe realiste të bazuar në të drejtën ndërkombëtare. "Hapi tjetër është për të ngritur normalizimin në një nivel të plotë dhe në të dyja anët është që, me ndihmën e Federica Mogherinit, të definohet marrëveshja me përmbajte ligjërisht obliguese", ka thënë Hahn për Tanjug.

## Zëvendëskryeministri i Kosovës: BE vendos shumë shpejt për vizat



Zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj pas kthimit nga Brukseli ka thënë se Kosova i ka përmbushur plotësisht kushtet për lëvizje të lirë pa viza. Në një përgjigje për Radion "Evropa e Lirë", Hoxhaj ka thënë se Kosova është drejt përfundimit të procesit të liberalizimit të vizave në zonën schengen. "Në takimet që kam pasur me komisionerët Johannes Hahn dhe Dimitris Avramopolos si dhe me shumë deputetë të Parlamentit Evropian është konfirmuar nga ana e institucioneve të BE-së se Kosova ka përmbushur plotësisht kushtet për lëvizje të lirë pa viza dhe brenda një kohe të shkurtër bëhet publik qëndrimi i Komisionit Evropian para shteteve anëtare dhe institucioneve tjera të BE-së. Po ashtu, brenda një kohe të shkurtër do të përmbyllet vendimmarrja brenda BE-së dhe shteteve anëtare dhe shumë shpejt qytetarët kosovarë do udhetojnë pa viza në Evropë", ka thënë zëvendëskryeministri Hoxhaj. Gjatë vizitës në Bruksel, Hoxhaj ka takuar komisionerin Johannes Hahn dhe Dimitris Avramopoulos. Po ashtu ai është takuar edhe me raportuesin për Kosovën në Parlamentin Evropian, Igor Soltes; raportuesen për viza për Kosovën, Tanja Fajon, si dhe zyrtarë të tjerë të lartë të institucioneve të Bashkimit Evropian.



# SHBA, Michell: Nëse Vuçiç s'e pranon propozimin për Kosovën, ka kush e pranon

SHBA-të dhe superfuqitë perëndimore i kanë dorëzuar planin e zgjidhjes për Kosovën presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiç, shkruan gazeta serbe "Blic". Pala serbe e ka vlerësuar planin si "të keq". Takimet e shpeshta të përfaqësuesve të vendeve të Kuintit, e sidomos veprimi i shpejtuar i administratës së presidentit amerikan, Donald Trump, nuk është i rastësishëm, vlerëson gazeta serbe. Vendet perëndimore ia kanë dorëzuar planin e tyre presidentit të Serbisë. Në përpilimin e këtij dokumenti kanë marrë pjesë Wess Mitchell, ndihmëssekretari i shtetit amerikan për Evropë dhe Euroazi dhe Helga Schmidt, zëvendësja e përfaqësueses së lartë të BE për politikë të jashtme dhe përfaqësuesi i Britanisë së Madhe, transmeton "Insajderi.com". "Presidenti serb është i vetëdijshëm se kjo ofertë e Perëndimit është joserioze, me të cilën nuk



**WESS MITCHELL**
"Nëse Vuçiç nuk e pranon këtë plan, ka kush e pranon, por mospranimii këtij plani do të ishte fund për të (Vuçiçin) dhe për Serbinë. Diplomacia perëndimore kërkon mbylljen urgjente të çështjes së Kosovës", ka thënë Mitchell.

mund të dalë para qytetarëve", pretendon burimi i gazetës. Wess Mitchell, disa pjesë të planit ia ka prezantuar edhe OJQ-ve serbe duke thënë haptas se Serbia është e detyruar ta pranojë këtë. Sipas njërit nga pjesëmarrësve nga radhët e OJQ-ve, është e qartë se Amerika po nxiton ta zgjidhë çështjen e Kosovës gjë që u përgjigjet edhe fuqive të mëdha të Perëndimit. Mitchell ishte shumë i drejtpërdrejt - thotë burimi i gazetës. - Ai iu kishte thënë pjesëmarrësve se, "nëse Vuçiç nuk e pranon këtë plan, ka kush e pranon, por mospranimi do të ishte fund për të (Vuçiçin) dhe për Serbinë". Me këtë rast, Mitchell ka folur edhe për mjetet financiare, të cilat i ka dedikuar Perëndimi për shpejtimin e gjithë këtij procesi. Kjo flet qartë se diplomacia perëndimore kërkon mbylljen urgjente të çështjes së Kosovës.

### Kryeministri serb: Serbia dhe Shqipëria kanë raporte të mira, merita është e Ramës

# Vuçiç: Pro kompromiseve, por jo të poshtëroj popullin tim

Serbia, Kosova, marrëdhëniet problematike mes dy vendeve dhe roli i Shqipërisë në këto raporte janë disa nga pikëpyetjet që presidenti serb, Aleksandër Vuçiç ka vendosur t'u përgjigjet në një intervistë ekskluzive për "Opinion", realizuar me gazetarin Idro Seferi. Vuçiç nuk ka ngurruar t'i japë meritë kryeministrit shqiptar për vendosjen e një raporti të mirë Serbi-Shqipëri.

Në marrëdhëniet e Serbisë dhe Shqipërisë, por edhe në rajon dhe rrugën drejt BE-së sigurisht shtrohet pyetja e Kosovës. Ju keni thënë se kjo është një prej temave më të dhimbshme për Serbinë, por gjithashtu keni nisur një dialog të brendshëm në kërkim të zgjidhjes më të mirë për Kosovën. E keni gjetur një përgjigje të tillë?

Për këtë pyetje do të më duheshin ditë dhe jo orë apo disa fjali. Së pari, Serbia dhe Shqipëria sot kanë marrëdhënie më të mira se më parë dhe për këtë ka meritë kryeministri shqiptar Edi Rama. Këtë nuk e kam penguar as unë dhe nëse asgjë tjetër pas shumë dekadash në të cilat nuk kemi pasur kurrfarë marrëdhëniesh, mendoj se kemi vendosur marrëdhënie racionale dhe normale, edhe pse



nuk do t'i vlerësoja si të jashtëzakonshme. Këto marrëdhënie janë të respektit dhe marrëdhënie në të cilat ne e kuptojmë se dallimi kryesor në një botë bashkëkohore që na rrethon është në fakt, Kosova dhe kur ju më shtroni këtë pyetje unë nuk kam nevojë t'i vardisem askujt. Këtë nuk e bëj as për shkak të publikut tim dhe besoj se kjo është ajo që njerëzit e respektojnë. Ta dinë njerëzit në Shqipëri që këtu mua një stadium i tërë me njerëz brohorasin "Vuçiç pederast", apo me emra të ndryshëm dhe të nesërmen, mbi 50 për qind e tyre votojnë për mua. Ajo që është e rëndësishme në fund është që njerëzit t'ju respektojnë, pasi për të na dashur, na duan fëmijët, prindërit dhe se di se kush, por është me rëndësi të kemi respekt. Sa i përket Kosovës dhe pyetjes suaj, ne kemi nisur një dialog të brendshëm, pasi kam konsideruar se është e rëndësishme që gjërat t'i shtrojmë në mënyrë racionale dhe reale, edhe pse kur e themi këtë, menjëherë shqiptarët nga Kosova thonë se racionale dhe reale është njohja e Kosovës. As kjo nuk është tërësisht racionale dhe reale dhe thirrja ime është që edhe njëra palë, edhe pala tjetër ta kuptojnë se nuk kemi shumë jetë, të gjithë kemi humbur shumë njerëz edhe serbët, edhe shqiptarët jo vetëm në konfliktet mes vetes, por edhe shumë që kanë ikur përgjithmonë nga këto hapësira. Këtu shtrohet pyetja nëse mundemi ne, të dyja palët të gjejmë diçka racionale, reale dhe që do të thoshte humbje për të dyja palët. Dhe kur është humbje për të dyja palët, kjo është minimumi i kënaqshëm edhe për njërën, edhe palën tjetër. Kjo do të na tërhiqte drejt së ardhmes dhe do të nënkuptonte që mund të flasim për një marrëdhënie tjetër mes serbëve dhe shqiptarëve, pasi në njëqind vitet e ardhshme, serbët dhe shqiptarët do të jenë dy popujt me të mëdhenj në Ballkanin Perëndimor. Çfarëdo të ndodhë më pas, të mos e analizojmë, por është reale që kjo do të jetë edhe më tutje, por në njëqind vite do të jenë dy popujt më të mëdhenj në Ballkanin Perëndimor. Unë mendoj se nga kjo lidhje 'very-jug', e cila do të duhej të jetë bazë e paqes në të ardhmen, varet e gjithë ajo që do të kemi edhe për njërën, edhe palën tjetër. Shqiptarët në Kosovë gabimisht konsiderojnë se i kanë mundur serbët, që serbët janë të gjunjëzuar dhe që duhet të fitojnë gjithçka që imagjinojnë dhe nuk shohin hapësirë për asnjë lloj kompromisi me Serbinë dhe serbët për këtë çështje. Serbët, nga ana tjetër, në besim të mirë dhe masë të madhe, e shohin se shqiptarët asnjëherë nuk mund të arrijnë legjitimitet ligjor në asnjë mënyrë pa Serbinë, pa Rusinë e Kinën në Kombet e Bashkuara.

KATALOGU

# Del lista me 2249 objekte, thesaret e zhdukura shqiptare

Fatmira Nikolli

*Nga dëshmitë arkeologjike te veprat e Vangjush Mios, imazhet e pasurive që humbëm*





Piktura, skulptura, objekte religjioze e objekte arkeologjike me datime e vlera të ndryshme, disa unike e të pazëvendësueshme, disa vepra të fundit të realizmit socialist- objekte të zbuluara në sitet më të rëndësishme arkeologjike të vendit, si edhe dëshmi e kulturës iliro-arbërore. Janë 2249 objekte të trashëgimisë kulturore shqiptare që janë zhdukur pas rënies së diktaturës në Shqipëri. Për disa imazhet mungojnë, sikundër edhe të dhëna të sakta, pasi nuk kanë qenë të pasaportizuara. Për disa të tjera, tanimë ka një katalog të objekteve të humbura, në shqip dhe anglisht. Ai është botim i përgatitur nga Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore, që ka gjithë bazën e të dhënave për objektet e mësipërme dhe regjistron gjithë pasurinë kulturore të vendit- private e publike.

Me publikimin e këtij katalogu, i cili përmbledh në një antologji imazhesh dhe të dhënash, objekte të trashëgimisë kulturore të deklaruara të humbura nga institucionet publike, Ministria e Kulturës dhe Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore rithekson faktin se është shumë e rëndësishme të kuptohet se trashëgimia kulturore nuk mund të dokumentohet, mbrohet e menaxhohet në mënyrë bashkëkohore vetëm nga institucionet qendrore, pa një bashkëpunim sistematik me institucionet e specializuar shtetërore të trashëgimisë kulturore, kalimit të kufirit, etj.

Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore ka përgatitur botimin "Katalogu i objekteve të humbura 1990 – 2016 të deklaruara të humbura nga Institucionet e Trashëgimisë Kulturore në Republikën e Shqipërisë". "Inventarit të pasurive kulturore që ruhen në fondet e Institucioneve publike në Republikën e Shqipërisë dhe të denoncuar prej tyre i mungojnë rreth 2249 objekte. Ritheksojmë, se ky është në total numri i deklaruar nga institucionet, por jo numri real i tyre. Janë me mijëra objekte të humbura, shumica prej të cilave përtej kufijve dhe është mjaft e vështirë, pothuajse e pamundur, identifikimi i tyre, sepse nga institucionet përkatëse ruhen vetëm listat e objekteve të vjedhura, dhe vetëm për një pjesë të tyre foto të objekteve",-thotë në një njoftim Ministria e Kulturës.



Sipas Silva Breshanit, drejtoreshë e QKIPK-së, vitet e tranzicionit në Shqipëri goditën rëndë institucionet e trashëgimisë kulturore e veçanërisht muzetë e Shqipërisë. "Dëmtimet më të mëdha të objekteve të trashëgimisë kulturore, u evidentuan në vitin 1997, si pasojë e vjedhjeve masive dhe shkatërrimit të kulturore në Shqipëri, nga elemente me prirje kriminale, për të përfituar në dëm të vlerave të pasurisë kulturore, duke shfrytëzuar dhe situatën e rëndë të sigurisë, të krijuar gjatë atij viti. U shkatërrua dhe u grabit një pjesë e rrjetit muzeor kombëtar. Shpesh herë i është vënë faji udhëtarëve të huaj, misioneve të huaja arkeologjike që shpesh herë cenuan trashëgiminë tonë kulturore, por të vetmit që e shkatërroi këtë pasuri kombëtare ishim vetë ne",-sqaron Breshani. Ajo shton se nëse humbim historinë tonë kemi humbur kulturën tonë, dhe kur humbim kulturën kemi humbur historinë, por, mbi të gjitha, identitetin tonë. "Nëse nuk e dokumentojmë e destinojmë drejt zhdukjes. Urimi më i mirë që mund të shpresojmë në këto kushte është, që në të ardhmen të kemi sa më pak nevojë të përgatisim e botojmë të tillë katalogë. Që do të thotë, në fakt, se veprat e artit dhe trashëgimia kulturore ka mbetur më në fund në duart e pronarëve të ligjshëm publikë apo privatë, për të dëshmuar të drejtat e kënaqësisë mbi artin, të bukurën dhe kapacitetet e arritura për të ruajtur me çdo kusht e çdo vend shenjat e qytetërimit tonë",-shkruan Breshani.




Mandej, Ministria e Kulturës, shton se për herë të parë dokumentohen në një punë serioze dhe përpjekje titanike objektet e humbura të trashëgimisë në Shqipëri.

"Me publikimin e këtij katalogu, i cili përmbledh në një antologji imazhesh dhe të dhënash, objekte të trashëgimisë kulturore të deklaruara të humbura nga institucionet publike, Ministria e Kulturës dhe Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore ritheksin faktin se është shumë e rëndësishme të kuptohet se trashëgimia kulturore nuk mund të, dokumentohet, mbrohet e menaxhohet në mënyrë bashkëkohore vetëm nga institucionet qendrore, pa një bashkëpunim sistematik me institucionet e specializuara shtetërore të trashëgimisë kulturore. Urimi më i mirë që mund të shpresojmë në këto kushte është, që në të ardhmen të kemi sa më pak nevojë të përgatisim e botojmë të tillë katalogë"- e mbyll njoftimin e saj Ministria e Kulturës.





Intervista e Ditës

Kryeministri për “Euronews”: Kam një ëndërr më të madhe, një Evropë të Madhe me shqiptarët brenda

# Rama me tone të ashpra BE-së: Negociatat janë çështje ‘jetë a vdekje’, të hapen në qershor

*(vijon nga faqja 1)*

... për ‘Euronews’, kreu i qeverisë shqiptare është shprehur se negociatat duhet të hapen në muajin qershor. Sipas tij, kjo nuk i kushton asgjë Evropës dhe nuk do të shpenzojnë asnjë cent për Shqipërinë. Më tej, kryeministri Rama sqaron se çelja e negociatave do të thotë se shqiptarët po shikojnë drejt së ardhmes dhe kanë lënë pas të shkuarën. Nuk na duhet një datë për të inkurajuar popullin. Ne duhet të hapim negociatat në qershor. Kjo është e gjitha. Dhe nuk na duhet asgjë tjetër. Vetëm të hapen negociatat dhe për Evropën kjo nuk kushton asgjë, nuk do të shpenzojnë asnjë cent për ne. Për ne, kjo është çështje jetë a vdekje, në kuptimin që hapja e negociatave do të thotë se ne po shikojmë drejt së ardhmes dhe kemi lënë pas të shkuarën.

**Serbia dhe Mali i Zi, që konsiderohen si vendet me më përparësi për integrimin, mund t’i bashkohen BE-së në vitin 2025. Kjo është një datë treguese. Kur mendoni se Shqipëria do të ndjekë hapat e këtyre vendeve?**

Sot po, Serbia dhe Mali i Zi janë në procesin e negociatave dhe janë përpara nesh në këtë proces. Por viti 2025 është një horizont ku të gjithë ne mund të arrijmë nëse punojmë shumë dhe bëjnë punën tonë.

**Ju duhet një datë për të inkurajuar popullin që të ndjekë të gjitha reformat e nevojshme?**

Nuk na duhet një datë për të inkurajuar popullin. Ne duhet të hapim negociatat në qershor. Kjo është e gjitha. Dhe nuk na duhet asgjë tjetër. Vetëm të hapen negociatat dhe për Evropën kjo nuk kushton asgjë, nuk do të shpenzojnë asnjë cent për ne. Për ne, kjo është çështje jetë a vdekje, në kuptimin që hapja e negociatave do të thotë se ne po shikojmë drejt së ardhmes dhe kemi lënë pas të shkuarën.

**Ka disa sfida të tjera që BE po i kushton rëndësi. Z.Juncker thotë se ka ende krim të organizuar dhe nuk dëshiron që kjo situatë të importohet në BE.**

Para së gjithash, nuk prisnim që presidenti Juncker apo dikush tjetër të na tregonte se kemi ende një luftë të madhe për të bërë me krimin e organizuar dhe korrupsionin. Thelbi është ky. Ne i kemi bërë detyrat e shtëpisë për hapjen e negociatave. Dhe makineria e Komisionit, që është një makineri e fuqishme me shumë ekspertë që merren me fakte dhe jo me lajme të rreme, na ka dhënë një rekomandim pozitiv pa kushte. Por që t’i ndash shtetet në vende me krim dhe vende pa krim, është më shumë se kaq. Nëse ekziston një krim i organizuar europian, është një krim i organizuar i ndërlidhur dhe ne duhet ta luftojmë bashkë.




**Duke folur për sfidat e brendshme, dua të flas për një çështje shumë të ndjeshme për BE-në, që është liria e medias. Dhe së fundmi ka pasur një raport nga Reporterët pa Kufij, që thotë se 80% e gazetarëve ndihen të pasigurt për të ardhmen dhe të ekspozuar nga fyerjet – thonë ata – nga Edi Rama që i ka quajtur ata kazanë dhe armiq. Ky është mendimi që keni për gazetarët e vendit tuaj?**

Kur them kazanë, në shqip është të njësoj si të thuash lajme të rreme (fake news), sepse nuk përkthehet mirë kjo fjalë në shqip. Nuk e kam fyer kurrë një gazetar personalisht. Unë sigurisht shpreh mendimin tim për mediat kazanë dhe kemi shumë media kazanë sot nëpër botë. Nëse ata kanë të drejtën e tyre për të shprehur mendimet, kjo nuk do të thotë që unë nuk kam të drejtë të shpreh mendimet e mia.

**Por i njëjti raport thotë, gjithashtu, se standardet manipulohen në interes të qeverisë.**

Kjo është një tjetër absurditet. Por nuk dua të flas…Është gjithmonë e dyshimtë kur dëgjon një kryeminsitër, një president apo një politikan të thotë se media po gënjen. Por media po gënjen shumë kohët e fundit. Ky është një problem. Dhe unë e respektoj shumë solidaritetin mes mediave dhe Reporterëve pa Kufij apo këdo tjetër. Ata bëjnë punën e tyre, unë bëj timen.

**E dimë se në Ballkan ka shumë shqiptarë dhe në shtete të tjera. Ju e perceptoni veten si lider të shqiptarëve, të popullit shqiptar apo jo?**

Në Kushtetutë, ne kemi për detyrim të mbrojmë shqiptarët kudo ku ndodhen jashtë vendit, por në të njëjtën kohë mendoj se shqiptarët nuk kanë qenë kurrë më mirë se sa sot. Në Kosovë, tani kanë shtetin e tyre. Në Maqedoni, janë pjesë e një revolucioni të vërtetë për ndryshimin e qasjes ndaj gjuhës shqipe dhe ndaj popullit shqiptar. Në jug të Serbisë, shpresoj që kushtet e tyre do të përmirësohen duke u bazuar në faktin se serbët në Kosovës trajtohen goxha mirë.

**Kohët e fundit keni hedhur idenë për një udhëheqës të përbashkët me Kosovën. Kjo shkaktoi shumë reagime.**

Më vjen keq për këto reagime, por qëllimi nuk ishte që të bëhej deklaratë tronditëse. Ishte më shumë një imagjinatë, në një situatë të veçantë në 10-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës. 20 vjet më parë, nëse dikush do të kishte folur për pavarësinë e Kosovës, do të kishte tronditur botën. Sot ja ku jemi dhe çfarë do të ndodhë 20 vitet e ardhshme? Dhe para se të thosha përse të mos kemi një President për dy vendet, kisha thënë se dialogu me Serbinë do të kishte përfunduar me sukses, shqiptarët dhe serbët do të ishin anëtarë të Bashkimit Europian. Kështu që, kishte shumë parakushte për të shkuar deri në pikën e një presidenti të përbashkët për të dy vendet.

**Pendoheni për këtë deklaratë?**

Jo.

**E përjashtoni projektin e bashkimit të shqiptarëve në të ardhmen, ndoshta?**

Jo. Gjithmonë e them se ëndrra ime është që të bashkohemi nën çatinë e Bashkimit Europian dhe nuk kam ëndërruar kurrë për një Shqipëri të Madhe, sepse unë kam një ëndërr më të madhe, një Evropë të Madhe me shqiptarët brenda saj.

**Ekziston një mendim se, projekti i zgjerimit të BE u riaktivizua, sepse në rajon kishte shumë prezencë të Rusisë, shumë prezencë të Turqisë dhe shumë prezencë të Kinës. Mendoni se këto shtete mund të përdorin rajonin e Ballkanit për të destabilizuar BE-në?**

Po, është një hapësirë boshe që dikush duhet ta mbushë. Dhe ky boshllëk i përket Europës dhe Bashkimit Europian. Kështu që, Bashkimi Europian duhet të marrë përgjegjësitë për këtë hapësirë strategjike, sepse, nëse është një hapësirë boshe, sigurisht që do të ketë të tjerë që do të përpiqen për ta mbushur.

Opinioni i Ditës

# Gazetaria analitike dhe ca mendime të Montanelit

Nga Sulejman Mato

*(vijon nga faqja 1)*




... nxënëse shkrimtarin Kolë Jakova, në një nga takimet që ne bënim dikur me lexuesin.

-Po,- iu përgjigj ai, por që të dalësh shkrimtar duhet të hysh shkrimtar...

Po shkollë për t'u bërë analistë a ka? Shkolla ka për t'u bërë analistë, por analisti duhet të ketë cilësi analisti dhe të ketë në kokë një bibliotekë të tërë. Një analisti i duhet jo vetëm dhe eksperiencë jetësore dhe profesionale, por dhe paanshmëri gjykimi, sinqeritet dhe vërtetësi, mbi të gjitha duhet të ketë integritet qytetar.

Mediat tona me sa duket e kanë gjetur më të lehtë për të ftuar në studiot e tyre, krahas analistëve të vërtetë dhe persona që nuk i kanë këto vlera e që mund t'i quajmë me plot të drejtë tifozë partish. Kohët e fundit mediat tona televizive i kanë shtuar rubrikat opinion-dhënëse. Ne kemi kohë që i ndjekim me interes këto debate televizive, te "Klan", "News 24","Ora Neës","Top Chanel", etj., mirëpo shpesh shohim të na shfaqen në panele krahas opinionistëve të përgatitur dhe disa të ashtuquajtur analistë, me pamje rëndësore, e që sa hapin gojën dhe një fshatar i thjeshtë i kupton se çfarë duan të thonë e cilin duan të mbrojnë.

Këtyre analistëve partiakë, përveç dijeve të plota u mungon dhe etiketa e mirësjelljes, flasin vend e pa vend dhe i ndërpresin fjalën kolegëve sikur të jenë duke bërë debat në një kafene.

Më rëndom kjo gjë vërehet te disa syresh kur kemi të bëjmë me debate politike apo me probleme që kërkojnë analiza të thella dhe qëndrime jo partiake. Analist do të thotë të jesh një gjykatës i paanshëm dhe një vërejtës i imët, për të zbuluar ca imtësira që nuk mund të vihen re nga syri i çdokujt. "Televizioni nxit interesin më të shëmtuar të gazetarëve të këqij, -ka thënë Indro Montaneli. **Kërkoni me çdo kusht bujën. Nëse dikush nga ju do të bëjë këtë profesion shpëtojini joshjes nga buja**."

Disa nga këta të vetëquajtur analistë, në debate të tilla duken si të dërguarit e partive politike, persona që mbrojnë partitë me tifozllëk, duke e deformuar debatin e duke e shndërruar atë një pazar kafshësh. Çudia më e madhe nis kur shikon gati të njëjtat fytyra që lëvizin nga një emision në tjetrin, madje ka raste që i sheh këto fytyra në një ditë në dy televizione njëherësh, që shtrihen paq në divanet e studiove televizive dhe ngrenë zërin duke dhënë gjykime dhe kur debatohet për gjykatat, pa pasur kulturë juridike dhe kur debatohet për fenë, pa pasur kulturë fetare, dhe për politikën e jashtme, pa qenë punonjës i asaj ministrie apo diplomat karriere, si dhe për figura botërore, Trampin, Putinin, Erdoganin, pa lexuar asnjë libër për historinë e jetës së tyre dhe për kufirin detar dhe për djallin dhe të birin...

Duke vërejtur cektësinë e këtyre debateve, për më tepër kur diskutojnë me pasion dhe hera -herës dhe me urrejtje për figura politike, dëgjuesit të thjeshtë që kërkon të mësojë diçka prej tyre, ia bën emisionin të pështirë. Kam venë re që, analistë të tillë, krahas krenarisë butaforike kanë jo vetëm delirin e madhështisë, por dhe paturpësinë që të paraqiten si persona që dinë gjithçka, ndërkohë që nuk ngrihen as mbi njohuritë e një debati kafenesh.

Kam mendimin që në këto debate televizive kur ngrihen probleme të rëndësishme kërkojnë pjesëmarrjen e profesorëve dhe doktorëve të shkencave, ose specialistëve dhe profesionalistëve të fushave përkatëse.

Media te dashura, në qoftë se doni të ruani imazhin tuaj të besueshëm hiqini qafe ca të vetëquajtur analistë. Analisti është një fjalë e madhe..."**Mbi të gjitha,**-thotë gazetari i njohur I.Montaneli,**-gazetaria kërkon shumë modesti."** Madiat në një pikëpamje, e kam thënë dhe një herë tjetër, janë shkolla të vërteta publike.

Nga të gjitha llojet e analistëve më diletantët janë analistët politikë...Disa prej tyre ju i njihni edhe vetë. Nuk ka nevojë për t'u përmendur emrat.

Ua kupton mendimin edhe pa hapur gojën. Këta lloj analistësh, janë të prirur, në mos të paguar për të mbrojtur dikë, me arsye dhe pa arsye. Populli sheh. Populli dëgjon. Populli gjykon...Populli herë pas here e mbyll me nervozizëm televizorin sa i sheh të shfaqen këta lloj analistësh.

> Më rëndom kjo gjë vërehet te disa syresh kur kemi të bëjmë me debate politike apo me probleme që kërkojnë analiza të thella dhe qëndrime jo partiake. Analist do të thotë të jesh një gjykatës i paanshëm dhe një vërejtës i imët, për të zbuluar ca imtësira që nuk mund të vihen re nga syri i çdokujt. "Televizioni nxit interesin më të shëmtuar të gazetarëve të këqij, -ka thënë Indro Montaneli.

Personalisht, kam pasur interes dhe kureshtje për t'i ndjekur disa nga këto emisione, dhe më ka ardhur keq për varfërinë e mendimit dhe partiprinë e tyre.

Nganjëherë kam dashur të kuptoj se çfarë mendon një fshatar, apo një tregtar që është rrozpatur gjatë ditës pas punëve të rëndomta, kur e ndjek me kujdes këtë _"pazar Korçe". Dëgjuesi në emisione të tilla ndihet si në një debat tifozërie, ku secili prej debatuesve kërkon të mbrojë me zjarr skuadrën e tij politike.

Të dashur moderatorë të këtyre emisioneve, na i hiqni qafe disa këta lloj analistësh, pasi jo vetëm dëmtojnë mendimin opinionist, por nxitin tek dëgjuesi një lloj atmosfere konfliktuale, duke e shtuar dhe më tej atmosferën konfliktuale parlamentare. Shqipëria, miqtë e mi, ka shumë profesorë, e doktorë, ka shumë specialistë të njohur për debate profesionale. Ju keni mundësi t'i ftoni në emisionet tuaja për të përfituar dhe ne nga dituria, por dhe përvoja dhe eksperienca e tyre. Ne dëgjuesit e këtyre emisioneve do të ishim shumë më përfitues po të shikonim në studiot tuaja persona të tillë. Doni emra? Ka kaq shumë personalitete vendi ynë, madje dhe në fushën e politikës. Pikërisht këta lloj analistësh do t'ju a bënin emisionet tuaja shumë interesante dhe do t'u shtonin respektin emisioneve të tilla. Ndofta dhe ju vetë jeni ndjerë mirë kur keni ftuar, dhe vazhdoni të ftoni në studiot tuaja personalitete dhe persona me reputacion në shoqëri.

## HOROSKOPI

### DASHI
Të kënaqur me surprizat e dhuruara nga Jupiteri që bashkëvepron me Uranin do të jeni shumë aktiv. Sot me të vërtetë do t'ia kaloni bukur! Do të keni dëshirë t'i përkushtoheni studimit të lëndëve të reja: mbi të gjitha preferoni shkencën dhe matematikën.

### DEMI
Merrni pak kohë për t'u menduar mbi mundësitë e reja profesionale, që ju janë ofruar. Më mirë të mos merrni vendime bazuar mbi entuziazmin momental. Nëse vazhdoni të mos ndiheni në lartësinë e duhur në disa situata, ashtu do të dalë me të vërtetë. Me shumë optimizëm!

### BINJAKET
Sot jeni të dashur dhe të shoqërueshëm dhe do të keni raporte më të mira me familjarët dhe miqtë. Dhe me Uranin që ju favorizon, do të tejkaloni vështirë që do t'ju dalin. Për ata që janë beqarë, pritet të ketë një takim që do t'ju ngjallë emocione të mëdha.

### GAFORJA
Plutoni parashikon vështirësi. Do të ndiheni nën trysni nga një sërë angazhimesh që do të keni. Do të shfaqen rivalitete dhe konkurrenca. Në familje pritet shumë nga ju dhe kjo ju vendos në vështirësi, duke bërë që të mos jeni tolerant.

### LUANI
Jupiteri, që ju favorizon, bëhet zëdhënës i lajmeve të mira, ftesa dhe risi të këndshme. Do të ndjeni emocione të këndshme të papërshkrueshme. Do të bëni disa ndryshime në shtëpi dhe gjithçka do të jetë edhe më e bukur se më parë.

### VIRGJERESHA
Gjatë ditë së sotme nuk do të jeni në humor të mirë. Do të kundërshtoni çdo që thoni. Mos e ekzagjeroni, ndërkaq! Do të jeni i tendosur dhe personi i zemrës do të vendosë t'ju shpërfillë, duke ju lënë të vetëm të tejkaloni shqetësimin që keni.

### PESHORJA
Bashkëveprimi i Plutonit me Uranin, do t'ju nxisë të shfrytëzoni sugjerimet që merrni dhe do t'ju shtyjë të shprehni krijimtarinë tuaj. Në dashuri do të përjetoni atë ndjesi intimiteti dhe përkatësie që ju emocionon e që ju dhuron qetësi.

### AKREPI
Mos e lini t'ju ikë një mundësi të bukur takimi për shkak të bindjes se nuk i përshtateni mjediseve të caktuara. Sigurisht që jeni i përshtatshëm. Provojeni që të besoni. Do të rropateni për të gjetur një ekuilibër midis lirisë vetjake dhe punës. Dhe në fund do t'ia dilni.

### SHIGJETARI
Bashkimi i Hënës me Saturnin do të nxisë prirjen për t'u mbyllur në vetvete, duke mos shfaqur emocione dhe ndjenja. Sot jeni të shpërqendruar dhe nervozë. Por, për fat, humori i keq është i përkohshëm dhe dielli do të ndriçojë!

### BRICJAPI
Ditën e sotme do të jeni autoritar dhe konkret. Edhe pse, për shkak të kundërshtive të vogla, do të përjetoni momente të mira e të këqija. Dorëzohuni përpara fakteve: zemra ju rreh fort për një person të veçantë, që deri më tani e keni shpërfillur!

### UJORI
Së bashku me Uranin, Mërkuri premton mrekulli! Është qershia mbi tortë për ata që duhen te përballen me një detyrë të rëndësishme në punë apo një provim. Jeni i qartë në mendime dhe keni një vizion të qartë për të ardhmen. Do ta doni atë që është risi.

### PESHQIT
Është dita e duhur për të kaluar momente të mira jashtë qytetit me miqtë. Dikush do t'ju bëjë të ëndërroni, do t'ju marrë për dore dhe do t'ju çojë në vende të shpirtit që nuk i keni njohur më parë. Kjo është mundësi e mirë për të gjetur personin e zemrës.

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al




Tashmë edhe lundroni!

